



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**

**MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT TË SHOQËRISË KOMISIONERE**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. 6, datë 26.01.2023*

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit për shoqërinë komisionere. Në përcaktimin e kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit zbatohet parimi i proporcionalitetit, në lidhje me llojet e shërbimeve të investimit që ofron shoqëria komisionere dhe madhësinë e aktivitetit të saj.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të nenit 54, pika 3, nenit 55, pika 2, pika 3 dhe pika 4 dhe nenit 56, pika 2 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, këtë e tutje i referuar si “Ligji”.

**Neni 3  
Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore do të zbatohet nga shoqëritë komisionere, të cilat rregullohen në përputhje me nenin 14 e vijues të Ligjit.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për bankat që ofrojnë shërbime investimi.

#### **Neni 4** **Përkufizime**

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- (a) “Faktorët K”, janë kërkesat për fondet e veta sipas risqeve që një shoqëri komisionere dhe agjentët e saj të lidhur paraqesin për klientët, tregjet dhe për vetë atë, të përcaktuara në Kreun IV të kësaj rregulloreje,
- (b) “aktive në administrim” ose “AUM”, është vlera e aktiveve që një shoqëri komisionere administron për klientët e saj si për administrimin e portofolit në mënyrë diskrecionale, ashtu edhe sipas marrëveshjeve jodiskrecionale që përbëjnë këshilla investimi të një natyre të vazhdueshme,
- (c) “mbajtja e parave të klientit” ose “CMH”, është shuma e parave të klientit që mban një shoqëri komisionere, duke marrë në konsideratë rregullimet ligjore në lidhje me ndarjen e aktiveve të shoqërisë komisionere nga paratë e klientëve,
- (d) “aktivet e ruajtura dhe të administruara” ose “ASA”, është vlera e aktiveve që një shoqëri komisionere mban dhe administron për klientët, pavarësisht nëse aktivet shfaqen në bilancin e vetë shoqërisë komisionere apo janë në llogaritë e palëve të treta,
- (e) “urdhëra të trajtuara të klientëve” ose “COH” është vlera e urdhërave që një shoqëri komisionere përpunon për klientët, nëpërmjet marrjes dhe transmetimit të urdhërave të klientit dhe nëpërmjet ekzekutimit të urdhërave në emër të klientëve,
- (f) “marzhi i klerimit” ose “CMG” është shuma e marzhit total të kërkuar për një anëtar klerimi ose kundërpalë qendrore, ku ekzekutimi dhe shlyerja e transaksioneve të një shoqërie komisionere që tregton për llogari të vet bëhen nën përgjegjësinë e një anëtari klerimi ose kundërpale qendrore,
- (g) “fluksi ditor i tregtimit” ose “DTF”, është vlera ditore e transaksioneve që një shoqëri komisionere kryen nëpërmjet tregtimit për llogari të vet ose ekzekutimit të urdhërave në emër të saj për interes të klientëve, duke përjashtuar vlerën e urdhërave që një shoqëri komisionere trajton për klientët nëpërmjet marrjes dhe transmetimit të urdhërave të klientit dhe nëpërmjet ekzekutimit të urdhërave në emër të klientëve, të cilat tashmë konsiderohen në kuadër të urdhërave të trajtuara të klientëve,
- (h) “rreziku i pozicionit neto” ose “NPR”, është vlera e transaksioneve të regjistruara në librin e tregtimit të një shoqërie komisionere,
- (i) “mospërbushja e kundërpalës tregtuese” ose “TCD”, është ekspozimi në librin e tregtimit të një shoqërie komisionere në instrumentet dhe transaksionet e përmendura në nenin 36 që sjellin rrezikun e mospërbushjes së kundërpalës tregtuese,
- (j) “vlera aktuale e tregut” ose “CMV”, është vlera neto e tregut të portofolit të transaksioneve ose të titujve që i nënshtrohen netimit në përputhje me nenin 42 të kësaj rregulloreje, ku vlerat pozitive dhe negative të tregut përdoren në llogaritjen e CMV-së,
- (k) “transaksione për shlyerje të gjata” janë transaksionet ku një kundërpalë merr përsipër të dorëzohë një titull, një mall apo një shumë këmbimi valutë kundrejt parave të gatshme, instrumenteve të tjera financiare ose mallrave, ose anasjelltas, në një datë shlyerjeje ose dorëzimi të përcaktuar në kontratë që është më vonë se standardi i tregut për këtë transaksion ose pesë ditë pune pas datës në të cilën shoqëria komisionere hyn në transaksion, cilado qoftë data më e hershme.
- (l) “transaksion financimi të titujve” ose “SFT” është : (a) një transaksion riblerjeje, (b) huadhënie e titujve ose mallrave dhe huamarrje e titujve ose mallrave; (c) një

- transaksion blerje-shitje (*back transaction*) ose transaksion shitje-blerje (*back transaction*); (d) një transaksion huadhënieje me marzh,
- (m) “llogari të ndara” janë llogaritë pranë shoqërisë ku depozitohen paratë e klientit që mbahen nga një shoqëri komisionere dhe që, në rast falimentimi, ose ndërhyrje të jazhtëzakonshme, ose administrimi të shoqërisë komisionere, paratë e klientit nuk mund të përdoren për të plotësuar pretendimet ndaj shoqërisë komisionere, përveç pretendimeve të klientit,
  - (n) “Të ardhurat totale bruto” janë të ardhurat vjetore operative të shoqërisë komisionere, në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e investimit të shoqërisë komisionere që ajo është e autorizuar të kryejë, duke përfshirë të ardhurat që rrjedhin nga interesi i arkëtueshëm, nga aksionet dhe titujt qofshin me yield fiks ose variabël, nga komisionet dhe tarifat, çdo fitim dhe humbje që shoqëria komisionere pëson nga tregtimi i aktiveve të saj, mbi aktivet e mbajtura me vlerën e drejtë, ose nga aktivitetet mbrojtëse (*hedging*), por duke përjashtuar çdo të ardhur që nuk është e lidhur me shërbimet dhe aktivitetet e investimit të kryera,
  - (o) “shoqëri komisionere” është një shoqëri në përputhje me nenin 3, pika 47 të Ligjit,
  - (p) “institucion tregu”, është një institucion në përputhje me nenin 3, pika 60 të Ligjit,
  - (q) “Rregullorja mbi raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” është Rregullorja e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
  - (r) “Risku i përqendrimit” ose “CON” është ekspozimi në librin e tregëtimit të shoqërisë komisionere ndaj një klienti apo një grupi klientësh të ndërlidhur kur vlera e këtij ekspozimi tejkalon kufijtë e përcaktuar në nenin 64 të kësaj rregulloreje.
  - (s) “Klientë të ndërlidhur” janë dy ose më shumë individë apo persona juridikë që përbëjnë një risk të vetëm, për arsye se një prej tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë ka kontroll mbi personin apo personat e tjerë. Klientë të ndërlidhur përbëjnë edhe personat që nuk janë të ndërlidhur për shkak të kontrollit, por që konsiderohet se përbëjnë një risk të vetëm, kur një prej tyre ka përjetuar vështirësi financiare, në veçanti vështirësi të ripagimit, duke shkaktuar vështirësi në financim dhe ripagim edhe tek personi apo personat e tjerë.
2. Përveç kësaj dhe nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, të gjitha përkufizimet e parashikuara këtu kanë të njëjtin kuptim si ato në Ligj.

## **KREU II**

### **NIVELI I ZBATIMIT TË KËRKESAVE**

#### **Neni 5**

#### **Objekti**

Kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit për shoqëritë komisionere përcaktohen në varësi të madhësisë dhe veprimtarive të rregulluara për të cilat është licencuar, në bazë të nenit 55, pika 1 dhe nenin 56, pika 1, të Ligjit në lidhje me sa vijon:

- (a) kërkesat për fondet e veta për shoqëritë komisionere,
- (b) kërkesat për shpenzimet fikse për shoqëritë komisionere,
- (c) burimet financiare të bazuara në risk për shoqëritë komisionere (faktorët K),
- (d) kapitalin fiks për shoqëritë me veprimtari të rregulluara të kufizuara,
- (e) kërkesat për likuiditet për shoqëritë komisionere,
- (f) kërkesat e raportimit në lidhje me pikat (a), (b) dhe (c) të këtij paragrafi,
- (g) kërkesat për dhënie të informacionit publik.

## **Neni 6**

### **Zbatimi i kritereve më të rrepta nga shoqëritë komisionere**

Kjo rregullore nuk pengon shoqëritë komisionere në mbajtjen e fondeve të veta dhe elementët përbërës të tyre, si dhe mbajtjen e aktiveve likuide në tejkalim ose zbatimin e masave që janë më të rrepta sesa ato të kërkuara nga kjo rregullore.

## **Neni 7**

### **Kategoritë e shoqërive komisionere**

Shoqëritë komisionere, për qëllim të kësaj rregulloreje, kategorizohen si më poshtë:

- (a) Shoqëritë komisionere të Kategorisë 'I' janë shoqëri me veprimtari të rregulluara të kufizuara në përputhje me nenin 56 të Ligjit ;
- (b) Shoqëritë komisionere të Kategorisë 'II' janë të gjitha shoqëritë e tjera komisionere që kryejnë veprimtari përtej veprimtarive të parashikuara për kategorinë 'I' sipas paragrafit (a) të këtij neni, përfshirë shoqëritë komisionere që ofrojnë shërbime ndihmëse sipas kuptimit të shkronjës (a), paragrafi 5, të nenit 3 të Ligjit dhe lejohen të mbajnë para ose aktive të klientit, dhe që ofrojnë shërbime investimi të renditura në shkronjat (a), (b), (c), (ç), (d), (dh) dhe (e), (ë), (f) të paragrafit 48, të nenit 3 të Ligjit
- (c) Shoqëritë Komisionere të përcaktuara sipas paragrafit (a) dhe (b) të këtij neni, që nuk tejkalojnë vlerat e përcaktuara në paragrafin (d) të këtij neni me kusht që vlerat 'ASA', 'CMH', 'DTF', 'NPR' të jenë të barabarta me zero, do të konsiderohen shoqëri të vogla dhe jo të ndërlidhura.
- (d) Shoqëritë komisionere të Kategorisë 'III' janë shoqëritë komisionere që plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:
  - (i) 'AUM' e matur në përputhje me nenin 44 të kësaj rregulloreje është e barabartë ose më e lartë se 70 miliardë lekë;
  - (ii) 'COH' e matur në përputhje me nenin 47 të kësaj rregulloreje është e barabartë ose më e lartë se 6 miliardë lekë në ditë për tregtimin në para ose 60 miliardë lekë për derivativët;
  - (iii) Totali brenda dhe jashtë bilancit i shoqërisë komisionere është i barabartë ose më i lartë se 6 miliardë lekë;
  - (iv) Të ardhurat totale bruto vjetore nga shërbimet dhe veprimtaritë e investimit të shoqërisë komisionere janë të barabarta ose më të larta se 1.8 miliardë lekë;
  - (v) Vlera e aseteve të ruajtura dhe administruara (ASA) më e lartë se zero lekë;
  - (vi) Vlera e parave të mbajtura për klientët (CMH) më e lartë se 0;
  - (vii) Fluksi ditor i tregëtimit (DTF) më i lartë se 0;
  - (viii) Rreziku i pozicionit neto (NPR) më i lartë se 0;
  - (ix) Mospërmbushja e kundërpalës tregtuese (TCD) më e lartë se 0.

**KREU III**  
**FONDET VETA DHE KËRKESAT**  
**PËR KAPITALIN E SHOQËRISË KOMISIONERE**

**Nënkreu 1**  
**Kërkesat e përgjithshme**

**Neni 8**  
**Përbërja e fondeve të veta**

1. Shoqëria komisionere duhet të kenë në çdo kohë fonde të veta të llogaritura si shumë e kapitalit të nivelit të parë, i cili përbëhet nga kapitali bazë i nivelit të parë dhe kapitali shtesë i nivelit të parë, dhe kapitali të nivelit të dytë, duke plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a)  $\frac{\text{Kapitali bazë i nivelit të parë}}{D} \geq 56\%$

(b)  $\frac{\text{Kapitali bazë i nivelit të parë} + \text{Kapitali shtesë i nivelit të parë}}{D} \geq 75\%$

(c)  $\frac{\text{Kapitali bazë i nivelit të parë} + \text{Kapitali shtesë i nivelit të parë} + \text{kapitali i nivelit të dytë}}{D} \geq 100\%$

ku:

- (i) Kapitali bazë i nivelit të parë përcaktohet në përputhje me Nënkreun 3, Seksionin 1 të këtij Kreu duke zbatuar filtrat prudencialë, kur është e zbatueshme, në përputhje me Nënkreun 3, Seksionin 4 të këtij Kreu,
  - (ii) Kapitali shtesë i nivelit të parë përcaktohet në përputhje me Nënkreun 3, Seksionin 2 të këtij Kreu duke zbatuar filtrat prudencialë, kur është e zbatueshme, në përputhje me Nënkreun 3, Seksionin 4 të këtij kreu,
  - (iii) Kapitali i nivelit të dytë përcaktohet në përputhje me Nënkreun 3, Nënseksionin 3 të këtij Kreu duke zbatuar filtrat prudencialë, kur është e zbatueshme, në përputhje me Nënkreun 3, Seksionin 4 të këtij Kreu dhe
  - (iv) D përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje.
2. Pavarësisht parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni dhe nenit 9 të kësaj rregulloreje që lidhet me kërkesat për fondet e veta, një shoqëri komisionere e Kategorisë 'I', do të respektojë kërkesën e fondeve të veta në përputhje me Nënkreun 2, të këtij Kreu.

**Neni 9**  
**Kërkesat për fondet e veta**

1. Një shoqëri komisionere duhet të ketë në çdo kohë fonde të veta në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje, të cilat arrijnë të paktën në vlerën e 'D'-së, ku D përcaktohet si më e larta nga sa vijon:

- (a) Kërkesat për shpenzime të përgjithshme fikse të llogaritura në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje,

- (b) Kapitali fillestar dhe i përhershëm në përputhje me nenin 17 të Ligjit; ose
- (c) Burimet financiare të bazuara në rrezik të shprehura si kërkesë e faktorit 'K', i llogaritur në përputhje me nenin 42 të kësaj rregulloreje.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, i këtij neni, një shoqëri komisionere e Kategorisë 'I' do të respektojë kapitalin fillestar dhe të përhershëm në përputhje me shkronjën (b) të paragrafit 1, të këtij neni.
  3. Pavarësisht nga paragrafi 1, i këtij neni, një shoqëri komisionere e Kategorisë 'II', treguesi 'D' do të përcaktohet si vlera më e lartë nga vlerat e specifikuar në shkronjat (a) dhe (b) të paragrafit 1, të këtij neni.
  4. Shoqëria komisionere e Kategorisë 'III' do të respektojë kërkesat për fondet e veta në përputhje me paragrafin (1), të këtij neni.
  5. Shoqëria komisionere do të njoftojë menjëherë Autoritetin me shkrim, kur nuk është në plotësim apo nuk do të jetë në plotësim të kërkesave të këtij neni.

## **Neni 10**

### **Kërkesa për shpenzimet e përgjithshme fikse**

1. Për qëllimet e shkronjës (a) të paragrafit (1) të nenit 9 të kësaj rregulloreje, kërkesa për shpenzime të përgjithshme fikse do të jetë të paktën një e katërta e shpenzimeve të përgjithshme fikse të vitit paraardhës.
2. Shoqëria komisionere do të përdorë shifrat që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore të audituara më të fundit, pas shpërndarjes së fitimeve. Kur pasqyrat financiare më të fundit të audituara të shoqërisë komisionere nuk pasqyrojnë një periudhë dymbëdhjetëmuajore, shoqëria do të pjesëtojë shumat e përfshira në ato pasqyra me numrin e muajve që pasqyrohen në ato pasqyra financiare dhe më pas do të shumëzojë rezultatin me dymbëdhjetë, në mënyrë që të rezultojë një shumë vjetore ekuivalente.
3. Nëse shoqëria komisionere nuk ka qenë në biznes për një vit nga data në të cilën ka filluar të ofrojë shërbime investimesh ose të kryejë veprimtari investimesh, ajo do të përdorë, për qëllime llogaritjeje të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, shpenzimet e përgjithshme fikse të parashikuara dhe të përfshira në projeksionet (projektet) e saj për tregtimin në 12 muajt e parë, siç janë paraqitur në kërkesën për licencë.
4. Llogaritja e shpenzimeve të përgjithshme fikse sipas paragrafit (1) të këtij neni përfshin diferencën mes shpenzimeve totale dhe zërave të mëposhtëm:
  - (a) shpërblimet e personelit dhe shpërblimet e tjera, në masën që varen nga fitimi neto i shoqërisë komisionere në vitin përkatës dhe nuk do të kenë asnjë ndikim në pozicionin e kapitalit të shoqërisë komisionere;
  - (b) aksionet e punonjësve, drejtorëve dhe ortakëve në fitimet e llogaritura mbi bazën e fitimeve neto;
  - (c) ndarjet e tjera të fitimeve dhe shpërblimeve të tjera variabël, në masën që ato janë plotësisht të lira;
  - (d) komisionet e përbashkëta dhe tarifatat e pagueshme që lidhen drejtpërdrejtë me komisionet dhe tarifatat e arkëtueshme, të cilat përfshihen në të ardhurat totale, dhe ku

- pagesa e komisionit dhe tarifave të pagueshme varet nga marrja aktuale e komisionit dhe tarifave të arkëtueshme;
- (e) tarifat për agjentët e lidhur;
  - (f) shpenzime jo të përsëritura nga aktivitete jo të zakonshme.

## **Nënkreu 2**

### **Shoqëritë me veprimtari të rregulluara të kufizuara**

#### **Neni 11**

##### **Dispozitat e përgjithshme**

Shoqëria që ushtron veprimtari të rregulluara të kufizuara në përputhje me nenin 56 të Ligjit do të respektojë kërkesat për fondet e veta, siç parashtrohet në këtë kre.

#### **Neni 12**

##### **Kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit**

1. Shoqëria me veprimtari të rregulluara të kufizuara duhet të ketë në çdo kohë fonde të veta të barabarta me shumën e kapitalit fiks.
2. Fondet e veta të barabarta me shumën e kapitalit fiks të shoqërive me veprimtari të rregulluara të kufizuara do të përcaktohen si kërkesë e përhershme e tyre për kapital minimal në përputhje me nenin 17, pika 3, të Ligjit.
3. Fondet e veta duhet të mbahen në përputhje me nenin 56, pika 3, të Ligjit.

## **Nënkreu 3**

### **Kërkesat për kapitalin**

#### **Seksioni 1**

##### **Kapitali bazë i nivelit të parë**

#### **Neni 13**

##### **Elementët përbërës të kapitalit bazë të nivelit të parë**

1. Kapitali bazë i nivelit të parë përbëhet nga elementet e mëposhtme:
  - (a) kapitali i paguar (aksione të zakonshme);
  - (b) primet e aksioneve të zakonshme;
  - (c) fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
  - (d) fitimi ushtrimor i fundit të vitit;
  - (e) fitimi ushtrimor i periudhës raportuese;
  - (f) rezervat;
  - (g) diferenca rivlerësimi kreditore.
2. Kapitali i paguar përbëhet vetëm nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat sipas përcaktimeve në Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Rezervat krijohen nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë komisionere pas zbritjes së tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve. Rezervat krijohen me vendim të organeve vendimmarrëse, në zbatim të akteve rregullatore të shoqërisë komisionere, si dhe të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
4. Rezervat e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni përfshijnë sa më poshtë:
  - (a) rezervat ligjore, të krijuara në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
  - (b) rezervat statutore, të krijuara në zbatim të përcaktimeve të statutit të shoqërisë komisionere;
  - (c) rezervat e tjera, të cilat përfaqësojnë të gjitha rezervat e tjera të krijuara nga shpërndarja e fitimit, me përjashtim të rezervave të shkronjës “a” dhe “b” të këtij paragrafi.

Në rezervat e tjera përfshihen edhe rezervat e përgjithshme, të cilat krijohen nga shoqëria komisionere në masën 1.25 për qind deri në 2 për qind të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me riskun. Këto rezerva krijohen duke zbritur një të pestën e fitimit të shoqërive komisionere pas zbritjes së tatimit dhe shpërndarjes së dividendëve. Shoqëria komisionere i përdor lirisht këto rezerva me qëllim mbulimin e rreziqeve të paidentifikuara në veprimtarinë e saj dhe nuk pasqyrojnë reduktimin e vlerës së një aktivi të caktuar.

5. Fitimet e pashpërndara, të cilat janë të lira nga çdo detyrim i ardhshëm, përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere, vetëm me miratimin e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për pjesën që parashikohet të jetë element përbërës i tij.
6. Shoqëritë komisionere përfshijnë fitimin e periudhës raportuese, si element të kapitalit bazë të nivelit të parë, vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
  - (a) është miratuar nga audituesi ligjor i shoqërisë komisionere;
  - (b) është zbritur çdo dividend i ndërmjetëm (pjesshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin.
7. Shoqëria komisionere paraqet me shkrim pranë Autoritetit dokumentet përkatës, të cilët evidentojnë plotësimin e kushteve të përcaktuara më sipër.

#### **Neni 14**

#### **Zbritjet nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë**

1. Shoqëria komisionere zbret nga zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë, elementet e mëposhtëm:
  - a) humbjet e periudhës raportuese;
  - b) aktivet e patrupëzuara;
  - c) aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme;
  - d) aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, që ndodhen në bilancin e shoqërisë komisionere;
  - e) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumente të veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, përfshirë instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë që shoqëria komisionere është e detyruar të blejë në bazë të një detyrimi aktual apo të mundshëm që buron nga një marrëdhënie kontraktore ekzistuese;



- f) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrument e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar në rastet kur këto subjekte kanë pjesëmarrje të kryqëzuara (reciproke) me shoqërinë komisionere, të cilat Autoriteti vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht fondet e veta të shoqërisë komisionere;
  - g) shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme në subjektet e sektorit financiar;
  - h) shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrument e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka investime të rëndësishme;
  - i) shumën e zërave që kërkohet të zbriten nga zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje, që tejkalon nivelin e kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere;
  - j) çdo shpenzim tatimor që lidhet me zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë, të parashikueshëm në momentin e përllogaritjes, përveç rasteve kur shoqëria komisionere rregullon shumën e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë në mënyrë të tillë që këto shpenzime të reduktojnë shumën deri në të cilën këto zëra (të kapitalit) mund të përdoren për të mbuluar rreziqet apo humbjet.
2. Shoqëria komisionere, për zbritjen e zërave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, zbaton kërkesat e përcaktuara në nenet 15 deri 20 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 15**

#### **Zbritja e aktiveve të patrupëzuara**

1. Shoqëria komisionere zbrit aktivet e patrupëzuara nga kapitali bazë i nivelit të parë, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (b) e kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere përllogarit shumën e aktiveve të patrupëzuara që duhet të zbritet në përputhje me përcaktimet e mëposhtme:
  - a) shuma që do të zbritet do të reduktohet me shumën e detyrimeve tatimore të shtyra të lidhura me aktivet e patrupëzuara, që do të fshiheshin nëse aktivet e patrupëzuara do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin nga bilanci;
  - b) shuma që do të zbritet do të përfshijë emrin e mirë (*goodwill*) që rezulton nga vlerësimi i investimeve të rëndësishme të shoqërisë komisionere.

### **Neni 16**

#### **Zbritjet e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali bazë i nivelit të parë aktivet tatimore të shtyra, realizimi i të cilave varet nga përfitueshmëria e ardhshme e shoqërisë komisionere, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (c) e kësaj rregulloreje.
2. Shuma e aktiveve tatimore të shtyra që varet nga përfitueshmëria e ardhshme mund të reduktohet me shumën e pasiveve tatimore të shtyra vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- a) shoqëria komisionere ka të drejtë të netojë aktivet tatimore korrente me detyrimet tatimore korrente në bazë të kuadrit ligjor;
  - b) aktivet tatimore të shtyra dhe pasivet tatimore të shtyra lidhen me tatimin mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe mbi të njëjtin subjekt tatimor.
3. Shoqëria komisionere, nuk mund të përdorë për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, pjesën e detyrimeve të shtyra tatimore që është përdorur për të reduktuar vlerën e aktiveve të patrupëzuara ose aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, të cilat zbriten nga kapitali bazë i nivelit të parë.
  4. Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, do të shpërndahet ndërmjet zërave të mëposhtëm:
    - a) aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;
    - b) të gjitha aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme.
  5. Shoqëria komisionere shpërndan pasivet tatimore të shtyra në përputhje me peshën e aktiveve tatimore të shtyra që mbështeten në përfitueshmërinë e ardhshme që përcaktohen në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 4 të këtij neni.

### **Neni 17**

#### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë**

1. Shoqëria komisionere, zbret nga kapitali bazë i nivelit të parë, pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të titujve indeks, në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, duke përfshirë instrumentet e kësaj kategorie që shoqëria komisionere është e detyruar të blejë në bazë të një detyrimi ekzistues ose të mundshëm që buron nga një kontratë ekzistuese, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (e) e kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere përcakton pjesëmarrjen në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, në bazë të pozicioneve bruto në blerje, duke bërë përjashtimet e mëposhtme:
  - a) shoqëria komisionere mund të përllogaritë shumën e pjesëmarrjes në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë në bazë të pozicioneve neto në blerje, me kusht që të plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme:
    - i. pozicionet në blerje dhe ato në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë dhe pozicionet në shitje nuk bartin rrezik kundërpattie,
    - ii. pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku në librin e shoqërisë komisionere;
  - b) shoqëria komisionere përcakton shumën që do të zbritet lidhur me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të titujve indeks, duke përllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të veta të kapitalit bazë të nivelit të parë të përfshira në ato indekse;

c) shoqëria komisionere mund të netojë pozicionet bruto në blerje në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë që rezultojnë nga pjesëmarrjet në tituj të indekseve me pozicionet në shitje në instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë, që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, përfshirë rastet kur këto pozicione në shitje bartin rrezik kundërpartie, me kusht që të përmbushen të dyja kriteret e mëposhtme:

- i. pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë në të njëjtin indeks bazë;
- ii. pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku në librin e shoqërisë komisionere.

### **Neni 18**

#### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, ku shoqëria komisionere ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) të krijuara për të rritur artificialisht kapitalin**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali bazë i nivelit të parë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, kur këto subjekte kanë pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me shoqërinë komisionere, të cilat Autoriteti vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e shoqërisë komisionere, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (f) e kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere zbrit pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
  - a) pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe instrumentet e tjera të subjekteve të sektorit financiar do të përlllogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;
  - b) për qëllime të kësaj zbritjeje, zërat e lidhura me sigurimin të kapitalit bazë të nivelit të parë do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë.

### **Neni 19**

#### **Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme në subjekte të sektorit financiar**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (g) e kësaj rregulloreje dhe që mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere, siç përcaktohet më poshtë në këtë nen.

2. Zbritjet që i referohen nenit 14 paragrafi 1, pika (g) e kësaj rregulloreje, të cilat nuk mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere do të zbatohen plotësisht pa aplikimin e mekanizmit të parashikuar në këtë nen.
3. Shoqëria komisionere përllorarit pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, në bazë të pozicionit neto në blerje në të njëjtin ekspozim bazë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti;
  - b) pozicionet në blerje dhe në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku në librin e shoqërisë komisionere;
4. Shoqëria komisionere përcakton shumën që do të zbritet në lidhje me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të titujve indeks, duke përlloragitur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në ato indekse.
5. Shoqëria komisionere zbret nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën që përlloragitet si produkt i shumëzimit të vlerës së përcaktuar në shkronjën “a” me faktorin e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:
  - c) shuma agregate për të cilën pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme, tejkalojnë 10% të shumës së kapitalit bazë të nivelit të parë. Për qëllime të kësaj pike, si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë do të konsiderohet ajo që rezulton pas zbatimit të:
    - i. seksionit 4 të këtij Nënkreu,
    - ii. zbritjeve të përcaktuara në nenit 14 paragrafi 1, pika (a) deri pika (f) dhe pika (j) të kësaj rregulloreje, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;
  - d) shuma e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme, pjesëtuar me shumën agregate të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit të vet të këtyre subjekteve të sektorit financiar.
6. Shoqëria komisionere përjashton nga shuma e përcaktuar në shkronjën “a” të paragrafit 5 të këtij neni dhe nga përlloraritja e faktorit të përcaktuar në shkronjën “b” të po atij paragrafi, pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për të paktën 5 ditë pune.
7. Shoqëria komisionere shpërndan shumën që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, midis të gjithë instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë që ajo mban. Shoqëria komisionere përcakton shumën e çdo instrumenti të kapitalit bazë të nivelit të parë që zbritet sipas paragrafit 5 të këtij neni, shumë që përlloragitet si produkt i shumëzimit të vlerës së përcaktuar në shkronjën “a” me faktorin e përcaktuar në shkronjën “b” të këtij paragrafi:
  - a) shuma e pjesëmarrjes së kërkuar për t’u zbritur sipas paragrafit 5 të këtij neni,

- b) pjesa e shumës të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme, përfaqësuar nga çdo instrument i kapitalit bazë të nivelit të parë që ajo mban.
8. Shuma e pjesëmarrjeve që i referohen paragrafit 1 të këtij neni, që është i barabartë ose më i vogël se 10% të zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere, nuk zbritet pas zbatimit të parashikimit në nënpikat (i) dhe (ii) të pikës (a) të paragrafit 5 të këtij neni.

## **Neni 20**

### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, ku shoqëria komisionere ka investime të rëndësishme**

1. Shoqëria komisionere zbritet nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka investime të rëndësishme, sipas nenit 14 paragrafi 1, pika (h) e kësaj rregulloreje.
2. Pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe instrumentet e tjera të subjekteve të sektorit financiar llogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje.
3. Shoqëria komisionere, për qëllime të zbritjes, do t'i trajtojë zërat që i përkasin kapitalit bazë të shoqërive të sigurimit si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë.
4. Shoqëria komisionere përllogarit pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar në bazë të pozicionit neto në blerje në të njëjtin ekspozim bazë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti;
  - b) pozicionet në blerje dhe në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit, ose së bashku mbahen në librin e jo-tregtimit;
5. Shoqëria komisionere përcakton shumën që do të zbritet në lidhje me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të titujve të indekseve, duke përllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në ato indekse:
  - a) shoqëria komisionere, për qëllime të kësaj zbritjeje, mund të përjashtojë nga përllogaritja e shumës që do të zbritet pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për të paktën pesë ditë pune. Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për më shumë se pesë ditë pune duhet të përfshihen në përllogaritje;
  - b) shoqëria komisionere mund të përjashtojë përkohësisht disa investime kur këto janë bërë në kuadrin e zgjidhjes ose ofrimit të ndihmës financiare për të riorganizuar një subjekt të sektorit financiar me probleme.

**Seksioni 2**  
**Kapitali shtesë i nivelit të parë**

**Neni 21**  
**Kapitali shtesë i nivelit të parë**

1. Kapitali shtesë i nivelit të parë përbëhet nga sa vijon:
  - (a) instrumentet e kapitalit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje;
  - (b) primet e lidhura me instrumentet e përcaktuara në shkronjën (a) të këtij paragrafi.
2. Instrumentet e përcaktuara në paragrafin 1, të këtij neni nuk mund të kualifikohen si kapital bazë i nivelit të parë dhe si kapital i nivelit të dytë.
3. Shoqëria komisionere mund të përfshijë instrumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në kapitalin shtesë të nivelit të parë, me kusht që të ketë marrë miratimin paraprak nga Autoriteti.
4. Autoriteti jep miratimin paraprak për përfshirjen e këtyre instrumenteve në kapitalin shtesë të nivelit të parë, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje.
5. Shoqëria komisionere, në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm si pjesë të kërkesës për marrjen e miratimit paraprak:
  - (a) dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt, etj.,) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;
  - (b) një informacion për plotësimin e kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë sipas shkronjës “a” të këtij neni;
  - (c) një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion nga një auditor ligjor në lidhje me pranueshmërinë e tyre;
  - (d) llogaritja e fondeve te veta dhe kërkesave për fondet e veta në ditën e fundit të muajit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit paraprak;
  - (e) një përlllogaritje e fondeve te veta dhe kërkesave për fondet e veta për periudhën e tre viteve të ardhshme.

**Neni 22**  
**Kushtet për njohjen e kapitalit shtesë të nivelit të parë**

1. Shoqëria komisionere përfshin instrumentet e kapitalit në kapitalin shtesë të nivelit të parë vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - (a) instrumentet janë emetuar dhe paguar;
  - (b) instrumentet nuk janë blerë nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:
    - (i) shoqëria komisionere apo filiale të saj,

- (ii) një shoqëri, në të cilën shoqëria komisionere ka një pjesëmarrje në formën e pronësisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet kontrollit, 20 % ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të asaj shoqërie;
- (c) blerja e instrumenteve nuk është financiar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga shoqëria komisionere;
  - (d) instrumentet renditen si instrumente të kapitalit të nivelit të dytë në rast të situatave të paaftësisë paguese dhe likuidimit;
  - (e) instrumentet nuk janë të siguruara ose të garantuara nga një prej subjekteve të mëposhtme, gjë që përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve:
    - (i) shoqëria komisionere ose filialet e saj;
    - (ii) shoqëria mëmë e shoqërisë komisionere ose filialet e saj,
    - (iii) çdo sipërmarrje që ka lidhje të ngushta me shoqëritë e përcaktuara në pikat (i) dhe (ii);
  - (f) instrumentet nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje apo kontrate që përmirëson përparësinë në këtë instrument, në situata të paaftësisë paguese ose të likuidimit;
  - (g) instrumentet janë të vazhdueshme dhe parashikimet që i rregullojnë ato nuk përfshijnë asnjë incentivë që shoqëria komisionere t'i shlyejë ato;
  - (h) kur instrumentet përfshijnë një ose më shumë opsione *call*, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit;
  - (i) instrumentet mund të thirren, të shlyhen ose të riblihen vetëm kur plotësohen kërkesat e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit;
  - (j) instrumentet nuk specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që ato mund ose do të thirren, shlyhen apo riblihen dhe shoqëria komisionere nuk parashtron ndryshe një tregues të tillë, përveçse në rastet që vijnë:
    - (i) likuidimi i shoqërisë komisionere,
    - (ii) riblerje të instrumenteve ose mënyra të tjera diskrete të reduktimit të shumës së kapitalit shtesë të nivelit të parë, ku institucioni ka marrë paraprakisht leje nga Autoriteti në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni;
  - (k) shoqëria komisionere nuk specifikon në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar se Autoriteti do të pranojë një kërkesë për tërheqje, shlyerje apo riblerje (*call, redeem, or repurchase*) të instrumenteve;
  - (l) pagesa e interesit (dividentit) siç përcaktohet në kontratën e këtyre instrumenteve, përmbush kushtet e mëposhtme:
    - (i) niveli i pagesës së interesit (dividentit) për këto instrumente nuk ndryshohet në bazë të klasifikimit të kredisë së shoqërisë komisionere ose të shoqërisë mëmë,
    - (ii) parashikimet që rregullojnë këto instrumente i japin diskrecion të plotë shoqërisë komisionere që, në çdo kohë, të anulojë shpërndarjen në instrumente për një periudhë kohe të pakufizuar dhe mbi baza jokumulative dhe shoqëria komisionere mund t'i përdorë këto pagesa të anuluar pa kufizim për shlyerjen e detyrimeve të saj,
    - (iii) anulimi i pagesave të interesit (dividentit, etj...) nuk përbën ngjarje mospërmbushjeje të shoqërisë komisionere,
    - (iv) anulimi i pagesave të dividentit nuk vendos kufizime mbi shoqërinë komisionere, duke përjashtuar pagesën e aksioneve të zakonshme;

- (m) dispozitat që rregullojnë këto instrumente përcaktojnë se, në rast të një ngjarjeje shkaktuese (*trigger event*), shumta e kryegjësë së instrumentit mund të zhvlerësohet (*written down*) në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, ose instrumenti mund të konvertohet në instrumente kapitali që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë;
- (n) parashikimet që rregullojnë këto instrumente nuk përmbajnë klauzola që pengojnë rikapitalizimin e shoqërisë komisionere;
- (o) në rastet kur këto instrumente nuk emetohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një shoqëri komisionere, duhet të plotësohen dy kushtet e mëposhtme:
  - (i) instrumentet të jenë të emetuara nëpërmjet një shoqërie që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të shoqërisë komisionere,
  - (ii) të ardhurat të jenë në dispozicion të menjëhershëm të shoqërisë komisionere pa kufizime.

2. Autoriteti jep miratimin paraprak për një ose të dy çështjet që vijojnë:

- (a) të zvogëlojë, të shlyejë ose të riblejë instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuara nga shoqëria komisionere në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të shoqërisë komisionere dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- (b) të kryejë thirrjen, shlyerjen, ripagimin ose riblerjen e instrumenteve shtesë të nivelit të parë ose instrumenteve të nivelit të dytë, nëse është e zbatueshme, përpara datës së maturimit të tyre.

### **Neni 23**

#### **Kufizime në anulimin e pagesave të interesit dhe parashikimet që mund të pengojnë rikapitalizimin e shoqërisë komisionere**

Parashikimet që rregullojnë instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë nuk përfshijnë:

- (a) kërkesën për pagesën e interesave (dividentëve, etj..) për t'u bërë në rast se bëhet një shpërndarje për një instrument të emtuar nga shoqëria komisionere që klasifikohet në të njëjtin nivel ose më të ulët sesa një instrument i përfshirë në kapitalin shtesë të nivelit të parë (*dividend pusher*);
- (b) detyrimin për pagesën e interesit ose dividentit nëpërmjet një pagese të çdo forme tjetër. Në të kundërt, shoqëria komisionere nuk do të ketë detyrimin për ndalimin e pagesave të interesit për instrumentet e kapitalit që përfshihen në kapitalin bazë ose shtesë të nivelit të parë dhe në kapitalin e nivelit të dytë, në rast se nuk janë kryer për këto instrumente kapitali të përfshira në kapitalin shtesë të nivelit të parë (*dividend stopper*);
- (c) detyrimin për zëvendësimin e pagesës së interesit ose dividentit me një pagesë të çfarëdo forme tjetër.

### **Neni 24**

#### **Kriteret për miratimin e ripagimit/shlyerjes ose konvertimit të instrumenteve të përfshira në kapitalin shtesë të nivelit të parë**

- 1. Për qëllime të shkronjës (m), paragrafi 1, neni 22 i kësaj rregulloreje, zbatohen parashikimet e mëposhtme mbi instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë:



- (a) një ngjarje nxitëse (*trigger event*) ndodh kur raporti kapital i kapitalit bazë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere bie nën përqindjen e përcaktuar në nenin 8, paragrafi (1), të kësaj rregulloreje;
  - (b) shoqëria komisionere mund të përcaktojë në parashikimet që rregullojnë instrumentin një ose më shumë ngjarje nxitëse, përveç atyre të referuara në shkronjën (a), paragrafi (1) i këtij neni;
  - (c) kur parashikimet që rregullojnë instrumentet kërkojnë konvertimin e tyre në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë në rast të ndodhjes së një ngjarjeje nxitëse, këto parashikime duhet të specifikojnë normën e konvertimit dhe një kufi të shumës që lejohet të konvertohet ose një interval brenda të cilit instrumentet do të konvertohen në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë.
  - (d) kur parashikimet që rregullojnë instrumentin përcaktojnë zhvlerësimin e tyre në rast të ndodhjes së një ngjarjeje nxitëse, zhvlerësimi duhet të reduktojë të gjithë elementet e mëposhtëm:
    - (i) detyrimin e mbajtësit të instrumentit, në rast paaftësie paguese ose likuidimi të shoqërisë komisionere,
    - (ii) shumën që kërkohet të paguhet në rast ushtrimi të opsionit *call* ose shlyerjeje të instrumentit,
    - (iii) pagesat e interesit (dividentit) të bëra mbi këtë instrument.
2. Zhvlerësimi apo konvertimi i një instrumenti të kapitalit shtesë të nivelit të parë gjeneron zëra që kualifikohen si instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë sipas kuadrit kontabël në fuqi.
  3. Shuma e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë, të njohura në këtë lloj kapitali, kufizohet në minimumin e shumës së elementeve bazë të kapitalit të nivelit të parë që mund të gjenerohen në rast se shuma e kryegjësë së instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë do të zhvlerësohej plotësisht ose do të konvertohej në instrument të kapitalit bazë të nivelit të parë.
  4. Shuma agregate e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë që është e detyrueshme të zhvlerësohet ose të konvertohet në rast të ndodhjes së ngjarjes nxitëse, nuk duhet të jetë më e vogël sesa shuma totale e principalit.
  5. Kur ndodh një ngjarje nxitëse, shoqëria komisionere do të kryejë veprimet e mëposhtme:
    - (a) njofton me shkrim Autoritetin menjëherë;
    - (b) njofton mbajtësit e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë;
    - (c) zhvlerëson kryegjënë e instrumenteve ose konverton pa vonesë instrumentet në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, por jo më vonë se një muaj nga data e ndodhjes së ngjarjes.
  6. Shoqëria komisionere që emeton instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë që konvertohen në kapital bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje nxitëse, duhet të sigurojë që kapitali aksioner i autorizuar të jetë në çdo kohë i mjaftueshëm, për të konvertuar të gjitha instrumentet e konvertueshme të kapitalit shtesë të nivelit të parë në aksione.
  7. Shoqëria komisionere siguron në kohë të gjitha miratimet paraprake të nevojshme në datën e emetimit të aksioneve që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë, në të cilët

do të konvertohen instrumentet që përfshihen në kapitalin shtesë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje nxitëse.

8. Shoqëria komisionere, e cila emeton instrumente që konvertohen në aksione që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje nxitëse, duhet të sigurohet se nuk ka pengesa procedurale në statusin e tyre për konvertimin në fjalë.

#### **Neni 25**

#### **Zbritjet nga kapitali shtesë i nivelit të parë**

Shoqëria komisionere zbret zërat e mëposhtëm nga kapitali shtesë i nivelit të parë:

- (a) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke përfshirë edhe vetë instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë që shoqëria komisionere është e detyruar t'i blejë si rezultat i detyrimeve kontraktuale ekzistuese;
- (b) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, me të cilat shoqëria komisionere ka pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara, për të cilat Autoriteti vlerëson se janë bërë me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale fondet e shoqërisë komisionere;
- (c) shumën e aplikueshme të përcaktuar në përputhje me nenin 29 të kësaj rregulloreje për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar, ku shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm në këto subjekte;
- (d) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike nga shoqëria komisionere në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka një investim të rëndësishëm në këto subjekte, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak;
- (e) shumën e zërave të zbritshëm nga kapitali i nivelit të dytë, sipas nenit 33 të kësaj rregulloreje që tejkalon kapitalin e nivelit të dytë të shoqërisë komisionere;
- (f) çdo shpenzim për taksa që lidhet me zëra të kapitalit shtesë të nivelit të parë të parashikueshme në momentin e llogaritjes së tij, përveç rasteve kur shoqëria komisionere rregullon në mënyrë të përshtatshme shumën e zërave të kapitalit shtesë të nivelit të parë, për sa kohë këto shpenzime për taksa do zvogëlojnë shumën deri në atë nivel, sa këto zëra mund të përdoren për të mbuluar rreziqet apo humbjet.

#### **Neni 26**

#### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë**

Për qëllime të pikës (a) të nenit 25 të kësaj rregulloreje, shoqëria komisionere do të përlllogarisi pjesëmarrjet në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë në bazë të pozicioneve bruto në blerje duke bërë përjashtimet e mëposhtme:

- (a) shoqëria komisionere mund të përlllogarisi shumën e pjesëmarrjes në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë në bazë të pozicioneve neto në blerje, me kusht që të plotësohen të dyja kriteret që vijojnë:
  - (i) pozicionet në blerje dhe ato në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë dhe pozicionet në shitje nuk bartin rrezik për asnjë kundërpalë;

- (ii) si pozicionet në blerje dhe ato në shitje mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku mbahen në librin jo të tregtimit të shoqërisë komisionere.
- (b) shoqëria komisionere përcakton shumën që do të zbritet lidhur me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të titjve indeks, duke përlllogaritur ekspozimin bazë ndaj instrumenteve të veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë të përfshira në ato indekse;
- (c) shoqëria komisionere mund të netojnë pozicionet bruto në blerje në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë që rezultojnë nga pjesëmarrjet tituj indeksesh me pozicionet në shitje në instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, përfshirë rastet kur këto pozicione në shitje mbartin rrezik për kundërpalën, me kusht që të plotësohen të dyja kriteret që vijojnë:
- (i) pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë në të njëjtin indeks bazë;
  - (ii) si pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku në librin jo të tregtimit.

#### **Neni 27**

#### **Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar dhe ku një shoqëri komisionere ka pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara, të krijuara për të rritur artificialisht fondet e veta**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali shtesë i nivelit të parë shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërive të sektorit financiar ku ato shoqëri kanë pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara me shoqërinë komisionere, të cilat Autoriteti vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e shoqërisë komisionere.
2. Shoqëria komisionere zbrit pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, në përputhje me sa vijon:
  - (a) pjesëmarrjet në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe në instrumentet e tjera të subjekteve financiare do të përlllogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;
  - (b) zërat që i përkasin kapitalit bazë të shoqërive të sigurimit do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë për qëllime zbritjeje.

#### **Neni 28**

#### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar**

Shoqëria komisionere do të bëjë zbritjet e nevojshme sipas pikave (c) dhe (d) të nenit 25 të kësaj rregulloreje duke llogaritur pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumentet shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar në bazë të pozicionit neto në blerje në të njëjtin ekspozim bazë me kusht që të plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- (a) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti;
- (b) pozicionet në blerje dhe në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit ose së bashku në librin jo të tregtimit të shoqërisë komisionere.

## Neni 29

### Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë kur një shoqëri komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm në një subjekt të sektorit financiar

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali shtesë i nivelit të parë shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku ato subjekte nuk kanë një investim të rëndësishëm në përputhje me pikën (c) të nenit 25 të kësaj rregulloreje dhe të cilat mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere, siç parashtrohet më poshtë në këtë nen.
2. Zbritjet e përcaktuara në pikën (c) të nenit 25 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere do të zbatohen plotësisht pa aplikimin e mekanizmit të dhënë në këtë nen.
3. Për qëllimet e pikës (c) të nenit 25 të kësaj rregulloreje, shoqëria komisionere do të përllogarisi shumën që do të zbritet duke shumëzuar shumën e dhënë në pikën (a) të këtij paragrafi me faktorin e gjeneruar nga llogaritja e referuar në pikën (b) të këtij paragrafi:
  - (a) shuma agregate për të cilën pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar, tejkalojnë 10 % të shumës së kapitalit bazë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere, pas zbatimit të sa vijon:
    - (i) nënseksionit 4 të këtij nënkreu,
    - (ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 14, paragrafi 1, pikat nga (a) deri në (f), dhe pikën (j), duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra mbështetur në përfitueshmërinë e ardhshme dhe që burojnë nga diferencat e përkohshme;
  - (b) shuma e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të atyre subjekteve të sektorit financiar, në të cilat shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm, pjesëtuar me shumën agregate të të gjitha pjesëmarrjeve agregate të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë të atyre subjekteve të sektorit financiar.
4. Shoqëria komisionere përjashton pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak, nga shuma e përcaktuar në shkronjën (a) të paragrafit (3) dhe nga përllogaritja e faktorit të përcaktuar në shkronjën (b) të paragrafit (3) të këtij neni.
5. Shuma që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni duhet të shpërndahet midis të gjithë instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë.

Shoqëria komisionere përcakton shumën e çdo instrumenti të kapitalit shtesë të nivelit të parë, i cili do të zbritet në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni duke shumëzuar shumën e specifikuar në shkronjën (a) të këtij paragrafi me përqindjen e specifikuar në shkronjën (b) të këtij paragrafi:

- (a) shumën e pjesëmarrjeve që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni;

(b) shumën e specifikuar në (i), pjesëtuar me shumën e specifikuar në (ii) në sa vijon:

- (i) shumën totale në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë,
- (ii) shumën agregate të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere në subjektet financiare kur shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm.

6. Shuma e pjesëmarrjeve të referuar në shkronjën (c) të nenit 25 të kësaj rregulloreje që është e barabartë me 10 % ose më pak të kapitalit bazë të nivelit të parë, pas zbatimit të dispozitave të parashtruara në shkronjat (a), (i) dhe (ii) të paragrafit (3) të këtij neni nuk do të zbritet.
7. Shoqëria komisionere përcakton shumën e pjesëmarrjeve në instrumentet e kapitalit që ponderohet me risk, duke shumëzuar shumën e specifikuar në shkronjën (a) me shumën e specifikuar në shkronjën (b), si vijon më poshtë:
  - (a) shumën e pjesëmarrjeve që duhet të ponderohen me risk sipas paragrafit (6) të këtij neni;
  - (b) përqindja që rezulton nga përlllogaritja në shkronjën (b) të paragrafit (5) të këtij neni.

### **Seksioni 3**

## **KAPITALI I NIVELIT TË DYTË**

### **Neni 30**

#### **Kapitali i nivelit të dytë**

1. Kapitali i nivelit të dytë përbëhet nga sa vijon:
  - (a) Instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë (dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë);
  - (b) primet e aksioneve të lidhura me instrumentet e përcaktuara në shkronjën (a) të këtij paragrafi.
2. Elementet e përfshira në shkronjën (a) të paragrafit (1) të këtij neni nuk kualifikohen si elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë ose si elemente të kapitalit shtesë të nivelit të parë.
3. Shoqëria komisionere mund të përfshijë elementet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, në kapitalin e nivelit të dytë, vetëm me miratimin paraprak të Autoritetit.
4. Autoriteti jep miratimin paraprak për përfshirjen e këtyre instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje.
5. Shoqëria komisionere, në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm si pjesë të kërkesës për marrjen e miratimit paraprak:
  - (a) dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt, etj.) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;

- (b) një ilustrim skematik të plotësimit të tipareve/kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë sipas shkronjës (a) të këtij paragrafi;
- (c) një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion të dhënë nga një auditues ligjor i autorizuar, në lidhje me pranueshmërinë e tyre;
- (d) llogaritja e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital në ditën e fundit të muajit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit paraprak;
- (e) një përlllogaritje e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital për periudhën e tre viteve të ardhshme.

### **Neni 31**

#### **Afatet dhe kushtet për njohjen e instrumenteve të kapitalit dhe të borxhit të varur të kapitalit të nivelit të dytë**

Shoqëria komisionere kualifikon si instrumente të kapitalit të nivelit të dytë instrumente të kapitalit dhe borxhin e varur, pavarësisht nga forma juridike ose trajtimi kontabël i tyre, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) instrumentet ose borxhi i varur të jenë emetuar nga shoqëria komisionere dhe të jenë plotësisht të paguar;
- (b) instrumentet të mos jenë blerë ose borxhi i varur të mos jetë financuar nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:
  - (i) shoqëria komisionere ose filialet e saj,
  - (ii) shoqëritë, në të cilat shoqëritë komisionere kanë një pjesëmarrje në formën e zotërimit (pronësisë), të drejtpërdrejtë ose me anë të kontrollit, 20 % ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre;
- (c) blerja e instrumenteve ose financimi i borxhit të varur nuk është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga shoqëria komisionere;
- (d) sipas parashikimeve të kontratës së instrumenteve ose të borxhit të varur, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerjeje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kryegjënë e instrumenteve ose pretendimin e borxhit të varur;
- (e) instrumentet ose borxhi i varur nuk janë të garantuara dhe nuk janë subjekt i një garancie që përmirëson prioritetin e pretendimeve nga një prej subjekteve të mëposhtme:
  - (i) shoqëria komisionere ose filialet e saj,
  - (ii) shoqëria mëmë e shoqërisë komisionere ose filialet e saj,
  - (iii) çdo sipërmarrje që ka lidhje të ngushta me shoqëritë e përcaktuara në pikat (i) dhe (ii);
- (f) instrumentet ose borxhi i varur nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje që në rastin e kundërt përmirëson përparësinë respektivisht për instrumentet ose borxhin e varur;
- (g) instrumentet ose borxhi i varur kanë një maturitet fillestar të paktën 5-vjeçar;
- (h) kur parashikimet e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk përfshijnë asnjë incentiv për të shlyer apo riblerë shumën e tyre të kryegjësë nga shoqëria komisionere, para afatit të maturimit;

- (i) kur dispozitat që rregullojnë instrumentet përfshijnë një ose më shumë opsione *call*, opsioni *call* mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (shoqërisë komisionere);
- (j) instrumentet ose borxhi i varur mund të ripaguhen/shlyhen vetëm kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 37 të kësaj rregulloreje dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit;
- (k) dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që këto instrumente ose borxhi i varur mund të ekzekutohen/shlyhen ose riblihen nga shoqëria komisionere vetëm në rastet e paaftësisë paguese apo likuidimit të shoqërisë komisionere;
- (l) parashikimet e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk i japin të drejtën zotëruesit të përshpejtojë planin e pagesave të interesave dhe të kryegjësë në të ardhmen, përveç rasteve të paaftësisë paguese apo likuidimit të shoqërisë komisionere;
- (m) niveli i pagesës së interesit ose dividendit për këto instrumente ose borxhin e varur, nuk ndryshohet në bazë të cilësisë së shoqërisë komisionere ose të shoqërisë komisionere mëmë;
- (n) në rastet kur këto instrumente ose borxhi i varur nuk janë emetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shoqëria komisionere, kur është e zbatueshme, duhet të plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
  - (i) instrumentet emetohen nëpërmjet një shoqërie që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të shoqërisë komisionere,
  - (ii) të ardhurat (fitimet) janë menjëherë në dispozicion të shoqërisë komisionere, pa kufizime.

### **Neni 32**

#### **Kriteret për miratimin e ripagimit/shlyerjes ose konvertimit të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë**

Shoqëria komisionere llogarit shumën në të cilën instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë kualifikohen/përfshihen si zëra të kapitalit të nivelit të dytë, gjatë pesë viteve të fundit të maturimit të instrumenteve, duke shumëzuar rezultatin e përftuar nga përlllogaritja në shkronjën (a) me shumën në shkronjën (b), si më poshtë:

- (a) shuma nominale e instrumenteve ose e borxhit të varur, në ditën e parë të periudhës së fundit pesëvjeçare të maturitetit kontraktual pjesëtuar me numrin e ditëve kalendarike në atë periudhë;
- (b) numri i ditëve të mbetura kalendarike të maturitetit kontraktual të instrumenteve ose borxhit të varur.

### **Neni 33**

#### **Zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë**

1. Nga kapitali i nivelit të dytë zbritet sa vijon:

- (a) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të një shoqërie komisionere në instrumentet e veta të përfshira në kapitalin e nivelit të dytë, duke përfshirë edhe instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë që një shoqëri komisionere është e detyruar t'i blejë, si rezultat i detyrimeve kontraktuale ekzistuese;

- (b) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar në të cilat shoqëria komisionere ka pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara, për të cilat Autoriteti vlerëson se janë krijuar me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale fondet e veta të shoqërisë komisionere;
  - (c) shumën e aplikueshme, të përcaktuar në përputhje me nenin 37 për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar, ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme në këto subjekte;
  - (d) pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar kur shoqëria komisionere ka një investim të rëndësishëm në ato shoqëri, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për më pak se pesë ditë pune.
2. Shoqëria komisionere zbresin nga kapitali i nivelit të dytë edhe shumën e investimeve të saj në ndërtesa dhe në mjete të tjera të qëndrueshme të trupëzuara që tejkalon 25% të fondeve të veta.

### **Neni 34**

#### **Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumente të veta të kapitalit të nivelit të dytë**

Për qëllime të shkronjës (a), paragrafi 1 i nenit 33 të kësaj rregulloreje, shoqëria komisionere llogarit pjesëmarrjet në bazë të pozicioneve bruto në blerje, për të cilat bëhen përjashtimet e mëposhtme:

- (a) shoqëria komisionere llogarit shumën e pjesëmarrjes në bazë të pozicionit neto në blerje, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - (i) pozicionet në blerje dhe në shitje të jenë në të njëjtin ekspozim bazë (*underlying exposure*) dhe pozicionet në shitje nuk bartin rrezik për kundërpalën,
  - (ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit, ose ato duhet të mbahen në librin jo të tregtimit të shoqërisë komisionere;
- (b) shoqëria komisionere përcakton shumën që do të zbritet për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në indekse të titujve, duke llogaritur ekspozimet bazë në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë në këto indekse;
- (c) shoqëria komisionere mund të netojë pozicionet bruto në blerje në instrumente të veta të kapitalit të nivelit të dytë, që rezultojnë nga zotërimet në indekse të titujve me pozicionet në shitje në instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë që rezultojnë nga pozicionet në shitje në indekset bazë, duke përfshirë ato pozicione që kanë rrezik për kundërpalën, me kushtin që të plotësohen të dyja kriteret e mëposhtme:
  - (i) pozicionet në blerje dhe në shitje janë të të njëjtit indeks bazë;
  - (ii) pozicionet në blerje dhe ato në shitje duhet të mbahen së bashku në librin e tregtimit, ose së bashku mbahen në librin jo të tregtimit të shoqërisë komisionere.



### **Neni 35**

#### **Zbritja e pjesëmarrjeve në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku shoqëria komisionere ka pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara të krijuara për të rritur artificialisht fondet e veta**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali shtesë i nivelit të dytë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar kur këto subjekte kanë pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara me shoqërinë komisionere, të cilat Autoriteti vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht fondet e veta të shoqërisë komisionere.
2. Shoqëria komisionere zbrit pjesëmarrjet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
  - (a) pjesëmarrjet në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë dhe instrumente të tjerë të shoqërive të sektorit financiar do të përlogariten në bazë të pozicioneve bruto në blerje;
  - (b) për qëllime të kësaj zbritjeje, zërat që i përkasin kapitalit shtesë të shoqërive të sigurimit do të trajtohen si pjesëmarrje në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë.

### **Neni 36**

#### **Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar**

Shoqëria komisionere bën zbritjet e përcaktuara në shkronjat (c) dhe (d) të nenit 33 të kësaj rregulloreje në përputhje me sa vijon:

- (a) shoqëria komisionere mund të përlogarisi pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar në bazë të pozicionit neto në blerje, në të njëjtin ekspozim bazë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - (i) maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose pozicioni në shitje është me maturitet të mbetur të paktën 1 vit;
  - (ii) të dyja pozicionet mbahen në librin e shoqërisë komisionere ose të dyja mbahen në librin e tregimit të shoqërisë komisionere;
- (b) përcaktojnë shumën që do të zbritet për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në indekse të titujve, duke llogaritur ekspozimet bazë në instrumente të kapitalit të shoqërive të sektorit financiar në këto indekse.

### **Neni 37**

#### **Zbritjet e pjesëmarrjeve në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë, ku shoqëria komisionere nuk ka investime të rëndësishme në një shoqëri të sektorit financiar**

1. Shoqëria komisionere zbrit nga kapitali shtesë i nivelit të parë shumën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërive të sektorit financiar ku ato shoqëri kanë një investim të rëndësishëm në

përputhje me shkronjën (c) të nenit 33 të kësaj rregulloreje dhe të cilat mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere, siç parashtrohet më poshtë në këtë nen.

2. Zbritjet e përcaktuara në shkronjën (c) të nenit 33 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk mbahen në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere do të zbatohen plotësisht pa aplikimin e mekanizmit të dhënë në këtë nen.
3. Për qëllimet e shkronjës (c) të nenit 33 të kësaj rregulloreje, shoqëria komisionere do të përllogarisi shumën që do të zbritet duke shumëzuar shumën e dhënë në shkronjën (a) të këtij paragrafi me faktorin e gjeneruar nga llogaritja e referuar në shkronjën (b) të këtij paragrafi:
  - (a) shuma agregate për të cilën pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë të subjekteve të sektorit financiar në të cilën shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm tejkalon 10 % të shumës së kapitalit bazë të nivelit të parë të shoqërisë komisionere, llogaritur pas aplikimit të sa vijon:
    - (i) Seksioni 4 i këtij Nënkreu,
    - (ii) zbritjeve të përcaktuara në nenin 14, paragrafi 1, shkronjat nga (a) deri në (f), si dhe shkronja (j) të kësaj rregulloreje, duke përjashtuar shumën e zbritshme lidhur me aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme;
  - (b) shuma e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë të atyre subjekteve të sektorit financiar, në të cilat shoqëritë komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm, pjesëtuar me shumën agregate të të gjitha pjesëmarrjeve agregate të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë të atyre subjekteve të sektorit financiar.
4. Shoqëria komisionere përjashton pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak nga shuma e përcaktuar në shkronjën (a) të paragrafit (3) dhe nga përllogaritja e faktorit të përcaktuar në shkronjën (b) të paragrafit (3) të këtij neni.
5. Shuma që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni duhet të shpërndahet midis të gjithë instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë. Shoqëria komisionere përcakton shumën e çdo instrumenti të kapitalit të nivelit të dytë duke shumëzuar shumën e specifikuar në shkronjën (a) të këtij paragrafi me përqindjen e specifikuar në shkronjën (b) të këtij paragrafi:
  - (a) shuma totale e pjesëmarrjeve që duhet të zbritet në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni;
  - (b) përqindja e shumës agregate të pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të shoqërisë komisionere në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar, në të cilat shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm, që përfaqësohet nga çdo instrument i mbajtur i kapitalit të nivelit të dytë.
6. Shuma e pjesëmarrjeve të përcaktuara në shkronjën (c) të nenit 33 të kësaj rregulloreje që është e barabartë me 10 % ose më pak të zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë të

shoqërisë komisionere pas zbatimit të dispozitave të parashtruara në shkronjat (a), (i) dhe (ii) të paragrafit (3) të këtij neni nuk do të zbritet.

#### **Seksioni 4 Filtrat prudencialë**

#### **Neni 38 Aktivet e titullzuara**

Shoqëria komisionere nuk përfshin në kapitalin e saj asnjë rritje të vlerës të kapitalit aksionar që rezulton nga aktivet e titullzuara, duke përfshirë sa vijon:

- (a) rritje që lidhet me të ardhurat e marzhit në të ardhmen, gjë që rezulton në fitim nga shitja;
- (b) fitimet neto, ku shoqëria komisionere është origjinuese e një titullzimi - që burojnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme nga aktivet e titullzuara që sigurojnë përmirësim të cilësisë kreditore për pozicionet e titullzimit.

#### **Neni 39 Rezervat e mbrojtjes së flukseve të parasë dhe ndryshimet në vlerën e detyrimeve të veta**

1. Shoqëria komisionere nuk përfshin në asnjë element të kapitalit të saj zërat e mëposhtëm:
  - (a) rezervat e vlerës së drejtë që lidhen me fitimet ose humbjet nga mbrojtjet e flukseve të parasë të instrumenteve financiare që nuk vlerësohen me vlerën e tyre të drejtë (*fair value*), përfshirë flukset e projektuara të parasë;
  - (b) fitimet ose humbjet nga detyrimet e shoqërisë komisionere që vlerësohen me vlerë të drejtë, që rezultojnë nga ndryshimet në vlerësimin kreditor (*credit rating*) të shoqërisë komisionere;
  - (c) të gjitha fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë që burojnë nga risku i kredisë së shoqërisë komisionere lidhur me detyrimet derivative;
2. Shoqëria komisionere, për qëllime të shkronjës (c) të paragrafit (1) në këtë nen, nuk kompenson fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë, që burojnë nga risku i kredisë së shoqërisë komisionere me ato që burojnë nga risku i kundërpalës.
3. Pa cenuar shkronjën (b) të paragrafit (1) të këtij neni, shoqëria komisionere mund të përfshijë në kapitalin e vet shumën e fitimeve dhe humbjeve nga detyrimet e saj kur ndryshimet në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë komisionere burojnë nga të njëjtat ndryshime në vlerësimin kreditor të shoqërisë komisionere.

#### **Neni 40 Rregullime të tjera të vlerës**

1. Shoqëria komisionere zbaton përcaktimet e bëra në këtë nen për të gjitha aktivet e matura me vlerën e drejtë (*fair value*) gjatë përlllogaritjes së fondeve të veta dhe zbret nga kapitali bazë i nivelit të parë shumën e çdo rregullimi vlere shtesë që mund të jetë i nevojshëm.

2. Shoqëria komisionere siguron që vlera e aplikuar për secilin prej pozicioneve të librit të saj të tregtimit të pasqyrojë saktë vlerën e tregut. Ky vlerësim duhet të pasqyrojë në mënyrë të përshtatshme natyrën dinamike të pozicioneve të librit të tregtimit dhe kriteret për qëndrueshmëri prudenciale të qenësishme në librin e tregtimit.
3. Shoqëria komisionere rivlerëson çdo ditë pozicionet e librit të tregtimit. Kur një çmim tregu nuk është i disponueshëm, ose kur, për disa produkte të konvertueshme, çmimi i tregut nuk pasqyron vlerën e brendshme të pozicionit, shoqëria komisionere përdor një metodë alternative vlerësimi, pasi të ketë informuar paraprakisht Autoritetin, me kusht që metoda të jetë mjaft prudente.
4. Shoqëritë komisionere regjistrojnë pozicionet që nga data e tregtimit të transaksioneve.

#### **Neni 41**

#### **Fitimet dhe humbjet e perealizuara të matura me vlerë të drejtë**

Shoqëria komisionere, përveç rastit të zërave të përcaktuar në nenin 39 të kësaj rregulloreje, nuk përjashton nga kapitali fitimet ose humbjet e perealizuara nga aktivet ose pasivet e matura me vlerë të drejtë.

### **KREU IV**

### **KRITERET PËR FAKTORIN K**

#### **Nënkreu 1**

#### **Parime të përgjithshme**

#### **Neni 42**

#### **Kërkesa për faktorin K dhe koeficientët e zbatueshëm**

1. Për qëllime të shkronjës (c) të nenit 9, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, kërkesa për faktorin K duhet të jetë të paktën në shumën sa vijon:
  - (a) Faktorët K të riskut për klientin (RtC) të llogaritur në përputhje me këtë Kre, Nënkreun 2 të kësaj rregulloreje,
  - (b) Faktorët K të riskut për tregun (RtM) të llogaritur në përputhje me këtë Kre, Nënkreun 3 të kësaj rregulloreje duke përdorur qasjen e standardizuar për rreziqet e tregut të përcaktuara në Rregulloren “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”,
  - (c) Faktorët K të riskut për shoqërinë (RtF) të llogaritur në përputhje me këtë Kre, Nënkreun 4 të kësaj rregulloreje.
2. Koeficientët e mëposhtëm do të zbatohen për faktorët K përkatës:

Tabela 1

<b>FAKTORËT K</b>		<b>KOEFICIENTI</b>
Asetet nën menaxhim, si nën menaxhimin diskrecional të portofolit, ashtu edhe nën marrëveshjet këshillimore jodiskrecionale të një natyre të vazhdueshme	K-AUM	0,02 %
Paratë e klientit të mbajtura	K-CMH (për llogaritë e ndara)	0,4 %
	K-CMH (për llogaritë jo të ndara)	0,5 %
Asetet e ruajtura dhe të administruara	K-ASA	0,04 %
Përpunimi i porosive të klientit	Tregtim me para në dorë K-COH	0,1 %
	Derivatet K-COH	0,01 %
Fluksi ditor i tregtimit	Tregtim me para në dorë K-DTF	0,1 %
	Derivatet K-DTF	0,01 %

3. Shoqëria komisionere monitoron vlerën e faktorëve K për çdo tendencë që mund të ketë efekt material në kërkesën për fonde të veta për periudhën e ardhshme raportuese dhe njofton Autoritetin me shkrim për këtë kërkesë materialisht të ndryshme për fonde të veta.

## Nënkreu 2 Faktorët K të Rtc-së

### Neni 43 Kërkesa për faktorin K të RtC-së

Kërkesa për faktorin K të RtC-së përcaktohet nga formula e mëposhtme:

$$K-AUM + K-CMH + K-ASA + K-COH$$

ku:

K-AUM është e barabartë me AUM të matur në përputhje me nenin 44, shumëzuar me koeficientin përkatës në nenin 42, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje,

K-CMH është e barabartë me CMH të matur në përputhje me nenin 45, shumëzuar me koeficientin përkatës në nenin 42, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje,

K-ASA është e barabartë me ASA të matur në përputhje me nenin 46, shumëzuar me koeficientin përkatës në nenin 42, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje,

K-COH është e barabartë me COH të matur në përputhje me nenin 47, shumëzuar me koeficientin përkatës në nenin 42, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje.

**Neni 44**  
**Matja e AUM-së për qëllimin e llogaritjes së K-AUM**

1. Për qëllimin e llogaritjes së K-AUM-së, AUM do të jetë mesatarja e rrumbullakosur e vlerës së totalit të aktiveve mujore nën administrim, e matur në ditën e fundit të punës të secilit prej 15 muajve të mëparshëm të konvertuar në monedhën funksionale të shoqërisë në atë kohë, duke përfshirë tri vlerat mujore më të fundit.
2. AUM do të jetë mesatarja aritmetike e 12 vlerave mujore të mbetura.
3. K-AUM do të llogaritet në ditën e parë të punës së çdo muaji.
4. Kur shoqëria komisionere ka deleguar zyrtarisht administrimin e aseteve tek një shoqëri tjetër financiare, ato aktive do të përfshihen në shumën totale të AUM-së të matur në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.
5. Kur një shoqëri tjetër komisionere ia ka deleguar zyrtarisht administrimin e aktiveve shoqërisë komisionere, ato aktive përfshihen nga shuma totale e aktiveve në administrim e matur në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.
6. Kur një shoqëri komisionere ka administruar aktivet për më pak se 15 muaj, ajo do të përdorë të dhënat historike për AUM-në për periudhën e specifikuar në paragrafin (1) të këtij neni, sapo të dhënat e tilla të bëhen të disponueshme për llogaritjen e K-AUM. Autoriteti mund të zëvendësojë pikat e munguara të të dhënave historike me përcaktime rregullatore bazuar në projeksionet e biznesit të shoqërisë komisionere të paraqitura në zbatim të nenit 16 të Ligjit.

**Neni 45**  
**Matja e CMH-së për qëllimin e llogaritjes së K-CMH**

1. Për qëllimin e llogaritjes së K-CMH, CMH do të jetë mesatarja e rrumbullakosur e vlerës së totalit të parave ditore të klientit, e matur në fund të çdo dite pune për nëntë muajt e mëparshëm, duke përfshirë tre muajt më të fundit.
2. CMH do të jetë mesatarja aritmetike e vlerave ditore të gjashtë muajve të mbetur.
3. K-CMH do të llogaritet në ditën e parë të punës të çdo muaji.
4. Kur një shoqëri komisionere ka mbajtur paratë e klientit për më pak se nëntë muaj, ajo do të përdorë të dhënat historike për CMH për periudhën e specifikuar në paragrafin (1) të këtij neni, sapo këto të dhëna bëhen të disponueshme për të llogaritur K-CMH. Autoriteti mund të zëvendësojë pikat e munguara të të dhënave historike me përcaktime rregullatore bazuar në projeksionet e biznesit të shoqërive komisionere të paraqitura në zbatim të nenit 16 të Ligjit.

**Neni 46**  
**Matja e ASA-s për qëllimin e llogaritjes së K-ASA**

1. Për qëllimin e llogaritjes së K-ASA, ASA do të jetë mesatarja e rrumbullakosur e vlerës së totalit të aktiveve ditore të ruajtura dhe administruara, e matur në fund të çdo dite pune për nëntë muajt e mëparshëm, duke përfshirë tre muajt më të fundit.

2. ASA do të jetë mesatarja aritmetike e vlerave ditore të gjashtë muajve të mbetur.
3. K-ASA do të llogaritet në ditën e parë të punës të çdo muaji.
4. Kur një shoqëri komisionere ia ka deleguar zyrtarisht detyrat e ruajtjes dhe administrimit të aktiveve një shoqërie tjetër financiare, ose kur një shoqëri tjetër financiare ia ka deleguar zyrtarisht këto detyra shoqërisë komisionere, këto aktive do të përfshihen në shumën totale të ASA-s, e cila matet në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.
5. Kur një shoqëri komisionere ruan dhe administron aktivet për më pak se gjashtë muaj, ajo do të përdorë të dhënat historike për ASA-n për periudhën e specifikuar në paragrafin (1) të këtij neni, sapo të dhëna të tilla bëhen të disponueshme për llogaritjen e K-ASA. Autoriteti mund të zëvendësojë pikat e munguara të të dhënave historike me përcaktime rregullatore bazuar në projeksionet e biznesit të shoqërisë komisionere të paraqitura në zbatim të nenit 16 të Ligjit.

#### **Neni 47**

#### **Matja e COH për qëllimin e llogaritjes së K-COH**

1. Për llogaritjen e K-COH, COH do të jetë mesatarja e rumbullakosur e vlerës së totalit të porosive ditore të përpunuara të klientit, e matur gjatë çdo dite pune gjatë gjashtë muajve të mëparshëm, duke përjashtuar tre muajt më të fundit.
2. COH do të jetë mesatarja aritmetike e vlerave ditore të tre muajve të mbetur.
3. K-COH do të llogaritet në ditën e parë të punës të çdo muaji.
4. COH do të matet si shuma e vlerës absolute të blerjeve dhe vlerës absolute të shitjeve si për tregtimin me para në dorë, ashtu edhe për derivativët në përputhje me sa vijon:
  - (a) për tregtimin me para në dorë, vlera është shuma e paguar ose e marrë për çdo tregtim,
  - (b) për derivativët, vlera e tregtimit është shuma e kontratës.
5. Shuma nocionale e derivativëve të normës së interesit do të rregullohet për kohën deri në maturim (në vite) të këtyre kontratave. Shuma do të shumëzohet me kohëzgjatjen e përcaktuar në formulën e mëposhtme:

$$\text{Kohëzgjatja} = \text{koha deri në maturim (në vite)} / 10$$

6. Pa cenuar paragrafin (8) të këtij neni, COH përfshin transaksionet e kryera nga shoqëria komisionere që ofron shërbime të administrimit të portofolit në emër të fondeve të investimeve.
7. COH do të përfshijë transaksionet që lindin nga këshillimi për investime në lidhje me të cilat një shoqëri komisionere nuk llogarit K-AUM.
8. COH përjashton transaksionet e përpunuara nga shoqëria komisionere, të cilat lindin nga shërbimi i portofolit të investimeve të një klienti ku shoqëria komisionere tashmë llogarit K-AUM në lidhje me investimet e atij klienti ose kur ky aktivitet lidhet me delegimin e

administrimit të aktiveve tek shoqëria komisionere që nuk kontribuon në AUM-në e asaj shoqërie komisionere në bazë të nenit 44, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje.

9. COH përjashton transaksionet e kryera nga shoqëria komisionere në emër të saj, ose për vete, ose për llogari të një klienti.
10. Shoqëria komisionere mund të përjashtojë nga matja e COH çdo porosi që nuk është ekzekutuar, kur një mosekzekutim i tillë ndodh për shkak të anulimit në kohë të porosisë nga klienti.
11. Kur një shoqëri komisionere ka përpunuar porosinë e klientëve për më pak se gjashtë muaj ose e ka bërë këtë për një periudhë më të gjatë si një shoqëri komisionere e vogël dhe jo e ndërlidhur, ajo do të përdorë të dhënat historike për COH për periudhën e specifikuar në paragrafin (1) të këtij neni sapo të bëhen të disponueshme këto të dhëna për llogaritjen e K-COH. Autoriteti mund të zëvendësojë pikat e munguara të të dhënave historike me përcaktime rregullatore bazuar në projeksionet e biznesit të shoqërisë komisionere të paraqitura në zbatim të nenit 16 të ligjit.

### **Nënkreu 3 Faktorët K të RtM-së**

#### **Neni 48 Kërkesa për faktorin K të RtM-së**

1. Kërkesa për faktorin K të RtM-së për pozicionet e librit të tregtimit të një shoqërie komisionere që merret për llogari të vet, qoftë për vete apo për llogari të një klienti, do të llogaritet K-NPR në përputhje me nenin 49 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere administron librin e tregtimit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.
3. Kërkesa për faktorin K të RtM-së zbatohet për të gjitha pozicionet e librit të tregtimit, të cilat përfshijnë veçanërisht pozicionet në instrumentet e borxhit (përfshirë instrumentet e titullizimit), instrumentet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive (CIU), këmbimin valutor dhe arin dhe mallrat (përfshirë kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve).
4. Për qëllimin e llogaritjes së kërkesës për faktorin K të RtM-së, një shoqëri komisionere përfshin pozicione të ndryshme nga pozicionet e librit të tregtimit, kur ato shkaktojnë rrezikun e këmbimit valutor ose rrezikun e mallit.

#### **Neni 49 Llogaritja e K-NPR**

Për qëllimin e llogaritjes së K-NPR, kërkesa për fondet e veta për pozicionet e librit të tregtimit të një shoqërie komisionere që tregton për llogari të vet, qoftë për vete apo për llogari të klientit, do të llogaritet duke përdorur metodën e standardizuar për riskun e tregut të përcaktuar në Rregulloren për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit.



## **Nënkreu 4** **Faktorët K të RtF-së**

### **Neni 50** **Kërkesa për faktorin K të RtF-së**

Kërkesa për faktorin K të RtF-së përcaktohet nga formula e mëposhtme:

$$K-TCD + K-CON=K-DTF$$

ku:

K-TCD është e barabartë me shumën e llogaritur në përputhje me nenin 52 të kësaj rregulloreje.

K-DTF është e barabartë me DTF e matur në përputhje me nenin 59 të kësaj rregulloreje, shumëzuar me koeficientin përkatës të përcaktuar në nenin 42, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje, dhe ku:

K-CON është shuma e përlllogaritur sipas nenit 66 të kësaj rregulloreje.

K-TCD do të bazohet në transaksionet e regjistruara në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere që tregon për llogari të vet, qoftë për vete apo për llogari të klientit.

K-DTF do të bazohet në transaksionet e regjistruara në librin e tregtimit të shoqërisë komisionere që tregon për llogari të vet, qoftë për vete apo për llogari të një klienti dhe transaksionet që shoqëria komisionere kryen nëpërmjet ekzekutimit të urdhrave në interes të klientëve në emrin e vet.

## **Nënsksioni 1** **Mospërbushja nga ana e kundërpalës tregtare**

### **Neni 51** **Objekti**

1. Ky nënsksion zbatohet për kontratat dhe transaksionet e mëposhtme:

(a) Kontratat derivative, përveç sa vijon:

- (i) kontratat derivative të lejuara drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një kundërpale qendrore (CCP) kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
  - pozicionet dhe aktivet e shoqërisë komisionere në lidhje me ato kontrata dallohen dhe veçohen, si në nivel të anëtarit të klerimit, ashtu edhe në CCP, nga pozicionet dhe aktivet e anëtarit të klerimit, ashtu edhe të klientëve të tjerë të atij anëtari klerimi dhe, si rezultat i këtij dallimi dhe veçimi, këto pozicione dhe aktive janë larg falimentimit, sipas Ligjit në rast mospagese (mospërbushjeje) ose paaftësie paguese të anëtarit të klerimit ose të një ose më shumë klientëve të tjerë të tij,
  - ligjet, rregulloret, rregullat dhe marrëveshjet kontraktuale të zbatueshme ose të detyrueshme për anëtarin e klerimit lehtësojnë transferimin e pozicioneve të klientit në lidhje me ato kontrata dhe

kolateralin përkatës tek një anëtar tjetër klerimi brenda periudhës së marzhit të zbatueshëm të riskut në rast mospagese (mospërbushjeje) ose paaftësie paguese të anëtarit fillestar të klerimit,

- shoqëria komisionere ka marrë një opinion ligjor të pavarur, të shkruar dhe të arsyetuar, i cili arrin në përfundimin se, në rast të një sfide ligjore, shoqëria komisionere nuk do të pësojë asnjë humbje për shkak të paaftësisë paguese të anëtarit të saj të klerimit ose të çfarëdo klienti të anëtarit të saj të klerimit,

- (ii) kontratat derivative *exchange-traded*,
- (iii) kontratat derivative të mbajtura për mbrojtjen e një pozicioni të shoqërisë komisionere,

- (b) transaksionet e shlyerjeve të gjata,
- (c) transaksionet e riblerjes,
- (d) transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së letrave me vlerë ose mallrave,
- (e) transaksionet e huadhënies me marzh,
- (f) çdo lloj tjetër SFT-je,
- (g) kreditë dhe huatë, nëse shoqëria komisionere kryen tregtimin në emër të klientit ose merr dhe transmeton urdhrin pa e ekzekutuar atë.

Për qëllimet e shkronjës (a), pika (i) të nënparagrafit të parë, kontratat derivative të lejuara drejtpërdrejtë ose tërthorazi nëpërmjet një CCP-je do të konsiderohen se plotësojnë kushtet e përcaktuara në atë pikë.

2. Transaksionet me llojet e kundërpalëve të mëposhtme përjashtohen nga llogaritja e K-TCD:

- (a) qeveritë qendrore dhe bankat qendrore,
- (b) bankat ndërkombëtare për zhvillim,
- (c) organizatat ndërkombëtare.

## **Neni 52 Llogaritja e K-TCD**

Për llogaritjen e K-TCD, kërkesa për fondet e veta do të përcaktohet me formulën e mëposhtme:

$$\text{kërkesa për fondet e veta} = \alpha \cdot EV \cdot RF \cdot CVA$$

ku:

$$\alpha = 1,2$$

EV = vlera e ekspozimit e llogaritur në përputhje me nenin 53 të kësaj rregulloreje;  
RF = faktori i riskut i përcaktuar për llojin e kundërpalës, siç përcaktohet në Tabelën 2;  
dhe  
CVA = rregullimi i vlerësimit të kredisë i llogaritur në përputhje me nenin 58 të kësaj rregulloreje.

Tabela 2

Tipi i kundërpalës	Faktori i riskut
Qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe shoqëritë e sektorit publik	1,6 %
Institucionet kredidhënëse dhe shoqëritë komisionere	1,6 %
Kundërpalët e tjera	8 %

### Neni 53

#### Llogaritja e vlerës së ekspozimit

Llogaritja e vlerës së ekspozimit do të përcaktohet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Vlera e ekspozimit} = \text{Max} (0; \text{RC} + \text{PFE} - \text{C})$$

ku:

RC = kosto zëvendësimi, siç përcaktohet në nenin 54 të kësaj rregulloreje,

PFE = ekspozimi i mundshëm në të ardhmen, siç përcaktohet në nenin 55 të kësaj rregulloreje dhe

C = kolateral, siç përcaktohet në nenin 56 të kësaj rregulloreje.

Kostoja e zëvendësimit (RC) dhe kolaterali (C) do të zbatohen për të gjitha transaksionet e përmendura në nenin 51 të kësaj rregulloreje.

Ekspozimi i mundshëm në të ardhmen (PFE) zbatohet vetëm për kontratat derivative.

Shoqëria komisionere mund të llogarisë një vlerë të vetme ekspozimi në nivel neto për të gjitha transaksionet që mbulohen nga një marrëveshje neto kontraktuale, në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 57 të kësaj rregulloreje. Kur ndonjë prej këtyre kushteve nuk plotësohet, shoqëria komisionere do ta trajtojë çdo transaksion sikur të ishte grupi i saj neto.

### Neni 54

#### Kosto e zëvendësimit (RC)

Kosto e zëvendësimit të përmendur në nenin 53 të kësaj rregulloreje përcaktohet si më poshtë:

- për kontratat derivative, RC përcaktohet si CMV,
- për transaksionet e shlyerjeve të gjata, RC përcaktohet si shuma e shlyerjes së mjeteve monetare (cash) që duhen paguar ose marrë nga shoqëria komisionere pas shlyerjes; një shumë e arkëtueshme duhet të trajtohet si një shumë pozitive dhe një shumë e pagueshme duhet të trajtohet si një shumë negative,
- për transaksionet e riblerjes dhe transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve ose mallrave, RC përcaktohet si shuma e parave të dhëna ose të marra hua; paratë e dhëna hua nga shoqëria komisionere duhet të trajtohen si një shumë pozitive dhe paratë e marra hua nga shoqëria komisionere duhet të trajtohen si një shumë negative,

- (d) për transaksionet e financimit me tituj, ku të dyja pjesët e transaksionit janë tituj, RC përcaktohet nga CMV e titullit të dhënë hua nga shoqëria komisionere; CMV do të rritet duke përdorur rregullimin përkatës të luhatshmërisë në Tabelën 4 të nenit 56 të kësaj rregulloreje,
- (e) për transaksionet e huadhënies me marzh dhe kreditë dhe huatë e përmendura në shkronjën (g) të nenit 51, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, RC përcaktohet nga vlera kontabël e aktivitetit në përputhje me standardet kontabël në fuqi.

## **Neni 55**

### **Ekspozimi i mundshëm në të ardhmen**

1. Ekspozimi i mundshëm në të ardhmen (PFE) i përmendur në nenin 53 të kësaj rregulloreje do të llogaritet për çdo derivat si produkt i:
  - (a) shumës efikase nocion (EN) të transaksionit të përcaktuar në përputhje me paragrafët (2) deri (6) të këtij neni; dhe
  - (b) faktori mbikëqyrës (FF) i përcaktuar në përputhje me paragrafin (7) të këtij neni.
2. Shuma efikase nocion (EN) do të jetë produkti i shumës nocion të llogaritur në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, kohëzgjatjes së saj të llogaritur në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni dhe deltën e saj mbikëqyrëse të llogaritur në përputhje me paragrafin (6) të këtij neni.
3. Shuma nocion, përveç rasteve kur shprehet qartë dhe fiksohet deri në maturim, do të përcaktohet si më poshtë:
  - (a) për kontratat derivative të këmbimit valutor, shuma nocion përcaktohet si shuma nocion e pjesës së kontratës në valutë të huaj, e konvertuar në monedhën vendase; nëse të dyja pjesët e një derivati të këmbimit valutor janë të shprehura në monedha të ndryshme nga monedha vendase, shuma nocion e secilës pjesë konvertohet në monedhën vendase dhe pjesa me vlerën më të madhe të monedhës vendase është shuma nocion,
  - (b) për kontratat e kapitalit dhe derivativëve të mallrave dhe kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve dhe derivativët e tyre, shuma nocion përcaktohet si produkt i çmimit të tregut të një njësie të instrumentit dhe numrit të njësisive të referuara nga tregtia,
  - (c) për transaksionet me fitime të shumëfishta që janë kontingjente shtetërore, duke përfshirë opsionet digjitale ose objektivat e riblerjes, një shoqëri komisionere do të llogarisë shumën nocion për çdo shtet dhe do të përdorë llogaritjen më të madhe që rezulton,
  - (d) kur nocioni është një formulë e vlerave të tregut, shoqëria komisionere duhet të vendosë CMV-të për të përcaktuar shumën tregtare,
  - (e) për swap-et nocion të ndryshueshme si swap-et amortizuese dhe akretuese, shoqëritë komisionere do të përdorin nocionin mesatar gjatë jetës së mbetur të swap-it si shumë tregtare,
  - (f) swap-et e levës financiare do të konvertohen në shumën nocion të swap-it ekuivalent të palëvruar në mënyrë që kur të gjitha normat në një swap shumëzohen me një faktor, shuma nocion e deklaruar shumëzohet me faktorin mbi normat e interesit për të përcaktuar shumën nocion,
  - (g) për një kontratë derivative me shkëmbime të shumëfishta të principalit, shuma nocion do të shumëzohet me numrin e shkëmbimeve të principalit në kontratën derivative për të përcaktuar shumën nocion.

4. Shuma nocion e kontratave me norma interesi dhe kontratave derivative të kredisë për kohën deri në maturim (në vite) të këtyre kontratave rregullohet sipas kohëzgjatjes së përcaktuar në formulën e mëposhtme:

$$\text{Kohëzgjatja} = (1 - \exp(-0,05 \cdot \text{koha deri në maturim})) / 0,05$$

Për kontratat derivative të ndryshme nga kontratat me normë interesi dhe kontratat derivative të kredisë kohëzgjatja do të jetë 1.

5. Maturimi i kontratës do të jetë data më e fundit deri në të cilën kontrata mund të vazhdojë të ekzekutohet.

Nëse derivativi i referohet vlerës së një norme tjetër interesi ose instrumenti kredie, periudha kohore do të përcaktohet në bazë të instrumentit bazë.

Për opsionet, maturimi do të jetë data më e fundit e ushtrimit kontraktual siç specifikohet në kontratë.

Për një kontratë derivative që është e strukturuar në mënyrë të tillë që në data të caktuara shlyhet çdo ekspozim i papaguar dhe termat rivendosen në mënyrë që vlera e drejtë e kontratës të jetë zero, maturimi i mbetur do të jetë i barabartë me kohën deri në datën tjetër të rivendosjes.

6. Delta mbikëqyrëse e opsioneve dhe opsioneve-swap mund të llogaritet nga vetë shoqëria komisionere, duke përdorur një model të përshtatshëm, që i nënshtrohet miratimit të Autoritetit. Modeli do të vlerësojë shkallën e ndryshimit të vlerës së opsionit në lidhje me ndryshimet e vogla në vlerën e tregut të instrumentit bazë. Për transaksione të ndryshme nga opsionet dhe opsionet-swap, ose kur asnjë model nuk është miratuar nga Autoriteti, delta do të jetë 1.
7. Faktori mbikëqyrës (SF) për çdo klasë aktivesh do të vendoset në përputhje me tabelën e mëposhtme:

Tabela 3

<b>Klasa e aktiveve</b>	<b>Faktori mbikëqyrës</b>
Norma e interesit	0,5 %
Këmbimi valutor	4 %
Kreditimi	1 %
Emri i vetëm i kapitalit	32 %
Indeksi i kapitalit	20 %
Kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve	18 %
Të tjera	32 %

8. Ekspozimi i mundshëm në të ardhmen i një grupi neto është shuma e ekspozimit të mundshëm në të ardhmen e të gjitha transaksioneve të përfshira në grupin neto, shumëzuar me:
- (a) 0,42, për grupe neto të transaksioneve me palët financiare dhe jofinanciare, për të cilat kolaterali këmbëhet në mënyrë bilaterale me palën tjetër,
- (b) 1, për grupe të tjera neto.

## Neni 56 Kolaterali

1. Ekspozimi i mundshëm në të ardhmen (PFE) i përmendur në nenin 53 të kësaj rregulloreje do të llogaritet për çdo derivat si produkt i:

Tabela 4

<b>Klasa e aktiveve</b>		<b>Transaksionet e riblerjes për rregullimin e luhatshmërisë</b>	<b>Transaksione të tjera për rregullimin e luhatshmërisë</b>
Titujt e borxhit të emetuara nga autoritetet qendrore ose bankat qendrore	≤ 1 vit	0,707 %	1 %
	> 1 vit ≤ 5 vjet	2,121 %	3 %
	> 5 vjet	4,243 %	6 %
Titujt e borxhit të emetuara nga shoqëri të tjera	≤ 1 vit	1,414 %	2 %
	> 1 vit ≤ 5 vjet	4,243 %	6 %
	> 5 vjet	8,485 %	12 %
Pozicionet e titullizimit	≤ 1 vit	2,828 %	4 %
	> 1 vit ≤ 5 vjet	8,485 %	12 %
	> 5 vjet	16,970 %	24 %
Aksionet e listuara dhe të konvertueshme		14,143 %	20 %
Tituj dhe mallra të tjera		17,678 %	25 %
Ar		10,607 %	15 %
Para (cash)		0 %	

Për qëllimet e Tabelës 4, pozicionet e titullizimit nuk do të përfshijnë pozicionet e rivlerësimit.

Autoriteti mund të ndryshojë rregullimin e luhatshmërisë për disa lloje mallrash për të cilët ka nivele të ndryshme luhatshmërie në çmime.

2. Vlera e kolateralit përcaktohet si më poshtë:
- për qëllimet e shkronjave (a), (e) dhe (g) të nenit 51, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, nga shuma e kolateralit të marrë nga shoqëria komisionere nga kundërpala e saj bëhet zbritja në përputhje me Tabelën 4;
  - për transaksionet e përmendura në shkronjat (b), (c), (d) dhe (f) të nenit 51, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, nga shuma e CMV-së së pjesës së tregtimit të titullit dhe shumës neto të kolateralit të postuar ose të marrë nga shoqëria komisionere.

Për transaksionet e financimit me tituj, ku të dyja pjesët e transaksionit janë tituj, kolaterali përcaktohet nga CMV e titullit të marrë hua nga shoqëria komisionere.

Kur shoqëria komisionere blen ose ka dhënë hua titullin, CMV-ja e titullit do të trajtohet si një shumë negative dhe do të reduktohet në një shumë më të madhe negative, duke përdorur rregullimin e luhatshmërisë në Tabelën 4. Kur shoqëria komisionere shet ose ka marrë hua titullin, CMV-ja e titullit do të trajtohet si një shumë pozitive dhe do të ulet duke përdorur rregullimin e luhatshmërisë në Tabelën 4.

Kur lloje të ndryshme transaksionesh mbulohen nga një marrëveshje kontraktuale neto, në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 57 të kësaj rregulloreje, rregullimet e

luhatshmërisë që zbatohen për "transaksionet e tjera" të Tabelës 4 do të zbatohen për shumat përkatëse të llogaritura sipas shkronjave (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë mbi bazën e emetuesit brenda çdo klase aktivesh.

3. Kur ka një mospërputhje monedhe midis transaksionit dhe kolateralit të marrë ose të postuar, do të zbatohet një rregullim shtesë i luhatshmërisë së mospërputhjes së monedhës prej 8 %.

### **Neni 57** **Netimi**

Për qëllimet e këtij Nënseksioni, shoqëria komisionere, *së pari*, mund t'i trajtojë kontratat që përputhen plotësisht, të përfshira në një marrëveshje netimi, sikur të ishin një kontratë e vetme me një principal të barabartë me arkëtimet neto, *së dyti*, transaksionet e tjera neto që i nënshtrohen novacionit, sipas të cilave të gjitha detyrimet ndërmjet shoqërisë komisionere dhe kundërpalës së saj bashkohen automatikisht në mënyrë të tillë që novacioni zëvendëson ligjërisht një shumë të vetme neto për detyrimet e mëparshme bruto, dhe *së treti*, transaksionet e tjera neto kur shoqëria komisionere siguron që kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- (a) një kontratë netimi me palën tjetër ose një marrëveshje tjetër që krijon një detyrim të vetëm ligjor mbulon të gjitha transaksionet e përfshira, të tilla që shoqëria komisionere do të kishte ose një pretendim për të marrë ose detyrim për të paguar vetëm shumën neto të vlerave pozitive dhe negative "mark to market" të transaksioneve individuale të përfshira në rast se një kundërpalë nuk arrin të realizojë synimin për shkak të njëres nga sa vijon:
  - (i) mospagesë (apo mospërmbushje)
  - (ii) falimentim,
  - (iii) likuidim, ose
  - (iv) rrethana të ngjashme,
- (b) kontrata e netimit nuk përmban asnjë klauzolë që, në rast të mospërmbushjes së një kundërpale, i lejon një kundërpale mospërmbushëse të bëjë pagesa të kufizuara, ose aspak, për palën mospërmbushëse, edhe nëse pala mospërmbushëse është një kreditore neto,
- (c) shoqëria komisionere ka marrë një opinion ligjor të pavarur, në formë të shkruar dhe të arsyetuar se, në rast të një sfide ligjore të marrëveshjes së netimit, pretendimet dhe detyrimet e shoqërisë komisionere do të ishin të barasvlershme me ato të përmendura në shkronjën (a) sipas regjimit ligjor të mëposhtëm:
  - (i) ligji i juridiksionit në të cilin është inkorporuar kundërpala,
  - (ii) nëse përfshihet një degë e huaj e një kundërpale, ligji i juridiksionit në të cilin ndodhet dega,
  - (iii) ligji që rregullon transaksionet individuale të përfshira në marrëveshjen e netimit; ose
  - (iv) ligji që rregullon çdo kontratë ose marrëveshje të nevojshme për të realizuar netimin.

## **Neni 58** **Rregullimi i vlerësimit të kredisë**

Për qëllimet e këtij nënseksioni, CVA nënkupton një rregullim në vlerësimin e tregut të mesëm të portofolit të transaksioneve me një kundërpalë që pasqyron CMV-në e riskut të kredisë së kundërpalës në shoqërinë komisionere, por nuk pasqyron CMV-në e riskut të kredisë së shoqërisë komisionere për kundërpalën. CVA do të jetë 1,5 për të gjitha transaksionet.

## **Nënseksioni 2 – Fluksi i tregtimit ditor**

### **Neni 59** **Matja e DTF-së për qëllimin e llogaritjes së K-DTF**

1. Për llogaritjen e K-DTF, DTF do të jetë mesatarja e rrumbullakosur e vlerës së fluksit total të tregtimit ditor, të matur gjatë çdo dite pune gjatë nëntë muajve paraardhës, duke përjashtuar tre muajt më të fundit.

DTF do të jetë mesatarja aritmetike e vlerave ditore të gjashtë muajve të mbetur.

K-DTF do të llogaritet në ditën e parë të punës të çdo muaji.

2. DTF do të matet si shuma e vlerës absolute të blerjeve dhe vlerës absolute të shitjeve si për tregtimin me para në dorë, ashtu edhe për derivativët në përputhje me sa vijon:
  - (a) për tregtimin me para në dorë, vlera është shuma e paguar ose e marrë për çdo tregtim,
  - (b) për derivativët, vlera e tregtimit është shuma e kontratës.

Shuma nocion e derivativëve të normës së interesit do të rregullohet për kohën deri në maturim (në vite) të këtyre kontratave. Shuma nocion do të shumëzohet me kohëzgjatjen e përcaktuar në formulën e mëposhtme:

Kohëzgjatja = koha deri në maturim (në vite) / 10

3. DTF do të përjashtojë transaksionet e përpunuara nga shoqëria komisionere për qëllimin e ofrimit të shërbimeve të administrimit të portofolit në emër të fondeve të investimeve.

DTF do të përfshijë transaksionet e kryera nga shoqëria komisionere në emër të saj, ose për vete, ose për llogari të një klienti.

4. Kur shoqëria komisionere ka pasur një fluks tregtimi ditor për më pak se nëntë muaj, ajo do të përdorë të dhënat historike për DTF për periudhën e specifikuar në paragrafin 1 sapo të bëhen të disponueshme këto të dhëna për llogaritjen e K-DTF. Autoriteti mund të zëvendësojë pikat e munguara të të dhënave historike me përcaktime rregullatore bazuar në projeksionet e biznesit të shoqërisë komisionere të paraqitura në zbatim të nenit 16 të ligjit.



**KREU V**  
**RISKU I LIKUIDITETIT PËR SHOQËRITË KOMISIONERE**

**Neni 60**  
**Kërkesa për likuiditetin**

1. Shoqëria komisionere mban një sasi aktivesh likuide ekuivalente me të paktën një të tretën e kriterit për shumën e shpenzimeve fikse të llogaritura në përputhje me nenin 10, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere e konsideruar si shoqëri e vogël dhe pa ndërlidhje në përputhje me nenin 7 paragrafi c të kësaj rregullore përjashtohen nga kërkesa e paragrafit 1 të këtij neni.
3. Për qëllime të paragrafit (1) të këtij neni, aktivet likuide të këtij neni përcaktohen nga Autoriteti me rregullore.
4. Shoqëria komisionere duhet të mbajë një sasi aktivesh likuide ekuivalente me të paktën një të tretën e kërkesës për shumën e shpenzimeve fikse të llogaritur në përputhje me nenin 10, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje.
5. Paratë e gatshme, depozitat afatshkurtra dhe instrumentet financiare që u përkasin klientëve, qoftë edhe të mbajtura në emër të shoqërisë komisionere, nuk do të trajtohen si aktive likuide për qëllime të paragrafit (1) të këtij neni.

**Neni 61**  
**Reduktimi i përkohshëm i kërkesës për likuiditet**

1. Shoqëria komisionere, në rrethana të jashtëzakonshme dhe pas miratimit nga Autoriteti, mund të ulë sasinë e aktiveve likuide të mbajtura.
2. Pajtueshmëria me kërkesën për likuiditet të përcaktuar në nenin 60, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje do të rivendoset brenda 30 ditësh nga reduktimi fillestar.

## **Kreu VI** **Risku i përqendrimit**

### **Neni 62** **Detyrimi për monitorim**

Shoqëria komisionere monitoron dhe kontrollon riskun e saj të përqendrimit në përputhje me kërkesat e këtij kreu, përmes procedurave të duhura administrative dhe të kontabilitetit si dhe përmes mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

### **Neni 63** **Përlllogaritja e vlerës së ekspozimit**

1. Për qëllim të këtij kreu, shoqëria komisionere që nuk plotëson kushtin për tu kualifikuar si shoqëri e vogël dhe jo e ndërlidhur sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, përlllogarit vlerën e ekspozimit lidhur me një klient apo grup klientësh të ndërlidhur duke përfshirë zërat e mëposhtëm:

a) tepricën pozitive të tejkaluar të pozicioneve të gjata (long) të shoqërisë komisionere ndaj pozicioneve të shkurtra (short) për të gjithë instrumentet financiare të librit të tregtimit për klientin në fjalë, pozicionin neto për çdo instrument financiar të përlllogaritur sipas nenit 49 të kësaj rregulloreje;

b) vlerën e ekspozimit të kontratave dhe transaksioneve me klientin, të përcaktuara në nenin 51 (1) dhe të përlllogaritura sipas nenit 53 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllim të paragrafit (a) të nenit 1 të kësaj rregulloreje shoqëria gjatë përlllogaritjes zbaton kërkesat e nenit 49 dhe nenit 67 të kësaj rregulloreje. Për qëllim të paragrafit (b) të nenit 1 të kësaj rregulloreje shoqëria mbështetet në përlllogaritjen e vlerave të transaksioneve dhe kontratave sipas metodës së përcaktuar nga Autoriteti.

3. Vlera e ekspozimit lidhur me një grup klientësh të ndërlidhur përlllogaritet duke mbledhur së bashku ekspozimet ndaj secilit individ brenda grupit, që do të konsiderohet si një ekspozim i vetëm.

4. Në përlllogaritjen e vlerës së ekspozimit lidhur me një klient apo grup klientësh të ndërlidhur shoqëria komisionere ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për identifikimin e aktiveve bazë të transaksionit si dhe kundërpalën për këto transaksione.

### **Neni 64** **Kufijtë lidhur me riskun e përqendrimit dhe tejkalimin e vlerës së ekspozuar**

1. Kufiri i shoqërisë komisionere përsa i përket riskut të përqendrimit të një vlere ekspozimi ndaj një klienti apo grupi të ndërlidhur klientësh duhet të jetë 25% të fondeve të veta të saj.

2. Nëse klienti i shoqërisë komisionere është një bankë apo një shoqëri tjetër komisionere, apo nëse një grup klientësh përfshin një apo më shumë banka apo shoqëri komisionere, atëherë kufiri që lidhet me riskun e përqendrimit duhet të jetë vlera më e lartë midis 25% të fondeve të veta të shoqërisë komisionere apo shumës prej 10 miliardë Lekë. Për të gjithë llojet e tjerë të klientëve apo grupeve të klientëve kufiri mbetet në vlerën 25%.

3. Kur shuma prej 10 miliardë Lekë është më e lartë se 25% të fondeve të veta, atëherë kufiri lidhur me riskun e përqendrimit nuk duhet të tejkalojë 100% të fondeve të veta.

4. Në rast të tejkalimit të kufijve të përcaktuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, shoqëria komisionere duhet të përmbushë detyrimin për njoftim sipas nenit 65 të kësaj rregulloreje si dhe të përmbushë detyrimin për fonde të veta për tejkalimin e vlerës së ekspozimit në përputhje me nenin 66 të kësaj rregulloreje.

5. Shoqëria komisionere përlogarit vlerën shtesë të ekspozimit ndaj një klienti apo grupi klientësh të ndërlidhur sipas formulës së mëposhtme:

Vlera shtesë e ekspozimit=  $EV - L$

Ku: EV është vlera e ekspozimit të përlogaritur sipas nenit 64 të kësaj rregulloreje, kurse L është kufiri lidhur me riskun e përqendrimit përcaktuar sipas këtij neni.

6. Vlera e ekspozimit lidhur me një klient apo grup klientësh të ndërlidhur nuk duhet të tejkalojë:

a) 500% të fondeve të veta të shoqërisë komisionere,

b) në vlerë agregate, 600% të fondeve të veta të shoqërisë komisionere, për çdo vlerë të tejkualuar që vazhdon për një periudhë prej më shumë se 10 ditësh.

7. Ekspozimet e mëposhtme përjashtohen nga kërkesa e këtij neni:

a) ekspozimet që zbriten nga fondet e veta të shoqërisë komisionere,

b) ekspozimet që shfaqen gjatë procesit të shlyerjes së shërbimeve të pagesave, të transaksioneve me monedha të huaja apo me tituj,

c) ekspozime që përbëjnë pretendime ndaj bankave qendrore, entiteteve të sektorit publik, organizatave ndërkombëtare, apo ekspozime që garantohen prej tyre, kur pesha e riskut të tyre për efekt të llogaritjes së ekspozimit është 0%.

### **Neni 65** **Detyrimi për njoftim**

1. Në rast të tejkalimit të kufijve të përcaktuar në nenin 64 të kësaj rregulloreje, shoqëria komisionere njofton pa vonesë Autoritetin për shumën e tejkualuar si dhe emrin e klientit, të cilit i referohet ky tejkualim dhe nëse është e zbatueshme, emrin e grupit të klientëve të ndërlidhur.

2. Autoriteti i kërkon shoqërisë komisionere ruajtjen e kufijve të ekspozimit në zbatim të nenit 64 të rregullores.

### **Neni 66** **Matja e CON për qëllim të llogaritjes së faktorit të riskut K-CON**

1. Kërkesa për fonde të veta shtesë sipas paragrafit 1 të këtij neni është shuma agregate e kërkesës për fonde të veta të përlogaritur për çdo klient apo grup klientësh të ndërlidhur sipas shumës së tejkualuar të paraqitur në kolonat përkatëse të tabelës 5 shumëzuar me:

(a) 200%, kur shuma e tejkualuar nuk ka zgjatur më shumë se 10 ditë,

(b) faktorin përkatës në kolonën 2 të tabelës 5, pas periudhës prej 10 ditësh, të përlogaritur nga data kur ka filluar të lindë tejkalimi i vlerës së ekspozimit (*excess*), duke e shpërndarë këtë shumë sipas kolonës 1 të tabelës 5.

2. Fondet e veta për efekt të shumës shtesë (*excess*) përlogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{OFRE} = \frac{\text{OFR}}{\text{EV}} * \text{EVE}$$

Ku: OFRE është kërkesa për fonde të veta për shumën e tejkaluar të ekspozimit

OFR = kërkesa për fonde të veta për ekspozimet ndaj një klienti apo grupi klientësh të ndërlidhur, të cilët konsiderohen si një ekspozim i vetëm.

EV është vlera e ekspozimit e përlogaritur sipas nenit 63 të kësaj rregulloreje

EVE është shuma e tejkaluar e vlerës së ekspozimit sipas përlogaritjes në nenin 64 të kësaj rregulloreje.

Tabela 5

<b>Kolona 1</b> <b>Vlera e tejkaluar e ekspozimit si përqindje ndaj fondeve të veta</b>	<b>Kolona 2</b> <b>Faktorët</b>
Deri 40%	200%
40% deri 60%	300%
60% deri 80%	400%
80% deri 100%	500%
100% deri 250%	600%
Mbi 250%	900%

### **Neni 67** **Llogaritja e K-CMG**

1. Për qëllim të nenit 48 të kësaj rregulloreje, Autoriteti lejon përlogaritjen e faktorit K-CMG nga shoqëria komisionere për të gjitha pozicionet që janë subjekt i klerimit, ose në rast portofoli, kur i gjithë ky portofol është subjekt i klerimit apo marzheve, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

(a) Shoqëria komisionere nuk është pjesë e një grupi që përfshin brenda tij një bankë,

- (b) klerimi dhe shlyerja e këtyre transaksioneve ndërmerret në përgjegjësinë e një anëtari klerimi të një kundërpale qendrore të licencuar (CCP), i cili është një bankë apo një shoqëri komisionere, dhe ku transaksionet janë kleruar ose në mënyrë qendrore ose përkundrejt metodës dorëzim kundrejt pagesës (DVP), në përgjegjësinë e plotë të anëtarit të klerimit,
- (c) përlllogaritja e marzhit total të kërkuar nga një anëtar klerimi është bazuar në një model që përdor anëtari i klerimit për marzhin e klerimit,
- (d) shoqëria komisionere i vërteton Autoritetit se zgjedhja për përlllogaritjen e faktorit të riskut të tregut RtM mbi bazën e faktorit K-CMG argumentohet mbi bazën e disa kritereve që përfshijnë edhe natyrën e aktiviteteve kryesore të shoqërisë komisionere, që janë kryesisht aktivitete tregtare, subjekt i klerimit dhe marzheve nën përgjegjësinë e një anëtari klerimi,
- (e) Autoriteti vlerëson se zgjedhja e portofolit, subjekt i K-CMG nuk është bërë me qëllim krijimin e një arbitrazhi rregullator në mënyrë të papërshtatshme dhe joproportionale lidhur me kërkesat për fondet e veta.

2. K-CMG është shuma e tretë më e lartë e marzhit total mbi bazë ditore që anëtari i klerimit i kërkon shoqërisë komisionere për tre muajt paraardhës, shumëzuar me faktorin 1,3.

## **KREU VII**

### **DHËNIA E INFORMACIONEVE NGA SHOQËRITË KOMISIONERE**

#### **Neni 68** **Objekti**

1. Shoqëria komisionere bën publike informacionet e specifikuar në këtë Kre në të njëjtën datë, kur publikon pasqyrat e veta financiare vjetore.
2. Shoqëria komisionere mund të përcaktojë median dhe vendndodhjen e duhur për të përmbushur në mënyrë efikase kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni.
3. Të gjitha informacionet do të jepen në një media ose vend ku është e mundur. Nëse i njëjti informacion ose një i ngjashëm me të publikohet në dy ose më shumë media, brenda secilës media do të përfshihet një referencë për informacionin e njëjtë në mediat e tjera.

#### **Neni 69** **Objektivat dhe politikat e administrimit të riskut**

Shoqëria komisionere publikon objektivat dhe politikat e saj të administrimit të riskut për secilën kategori të veçantë të riskut në përputhje me nenin 68 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë një përmbledhje të strategjive dhe proceseve për të menaxhuar këto risqe dhe një deklaratë koncize për riskun, të miratuar nga organi drejtues i shoqërisë komisionere që përshkruan shkurtimisht profilin e përgjithshëm të riskut të shoqërisë komisionere ose institucioneve të tregut të lidhur me strategjinë e biznesit.

## **Neni 70**

### **Administrimi**

Shoqëria komisionere duhet të japë informacionet e mëposhtme në lidhje me procedurat e brendshme të administrimit, në përputhje me nenin 68 të kësaj rregulloreje:

- (a) anëtarët e organit drejtues,
- (b) politikën për diversitetin në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të organit drejtues, objektivat e tij dhe çdo objektiv përkatës të përcaktuar në atë politikë, si dhe masën në të cilën ato objektiva dhe qëllime janë arritur,
- (c) nëse shoqëria komisionere ka ngritur ose jo një komitet të veçantë risku dhe numrin e herëve që komiteti i riskut është mbledhur çdo vit.

## **Neni 71**

### **Fondet e veta**

Shoqëria komisionere jep informacionet e mëposhtme në lidhje me fondet e veta, në përputhje me nenin 68 të kësaj rregulloreje:

- (a) gjendjen e zërave të kapitalit bazë të nivelit të parë, zërave të kapitalit shtesë të nivelit të parë, zërave të kapitalit të nivelit të dytë dhe filtrave të zbatueshëm, si dhe zbritjeve që aplikohen në fondet e veta të shoqërisë komisionere, bilanci sipas pasqyrave financiare të audituara të shoqërisë komisionere,
- (b) një përshkrim të veçorive kryesore të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë të emetuara nga shoqëria komisionere,
- (c) një përshkrim të të gjitha kufizimeve të aplikuara për llogaritjen e fondeve të veta në përputhje me këtë rregullore dhe instrumentet dhe zbritjet për të cilat zbatohen këto kufizime.

## **Neni 72**

### **Kërkesat për fondet e veta**

Shoqëria komisionere jep informacionet e mëposhtme në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e parashtruara në nenin 8, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me nenin 68 të kësaj rregulloreje:

- (a) një përmbledhje të qasjes së shoqërisë komisionere për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të saj të brendshëm për të mbështetur aktivitetet aktuale dhe të ardhshme,
- (b) me kërkesë të Autoritetit, rezultati i procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të shoqërisë komisionere, duke përfshirë përbërjen e fondeve të veta shtesë bazuar në procesin e rishikimit mbikëqyrës,
- (c) nëse është e zbatueshme, kërkesat e faktorit K të llogaritura, në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje, në formë të përmbledhur për RtM, RtF dhe RtC, bazuar në shumën e faktorëve K të zbatueshëm; dhe
- (d) nëse është e zbatueshme, kriteret për shpenzime të përgjithshme fikse të përcaktuara në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje.

**KREU VIII**  
**RAPORTIMI I SHOQËRISË KOMISIONERE PRANË AUTORITETIT**

**Neni 73**

**Kërkesat e raportimit për shoqërinë komisionere**

1. Shoqëria komisionere duhet të raportojë pranë Autoritetit çdo tre muaj të gjitha informacionet e mëposhtme:
  - (a) nivelin dhe përbërjen e fondeve të veta;
  - (b) kërkesat për fondet e veta;
  - (c) llogaritjet e kërkesave për fondet e veta;
  - (d) nivelin e aktivitetit në lidhje me kushtet e përcaktuara në nenin 8, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, duke përfshirë bilancin dhe analizën e të ardhurave sipas shërbimit të investimit dhe, nëse është e aplikueshme, faktorin K;
  - (e) risku i përqendrimit;
  - (f) kërkesat për likuiditet.
  
2. Pavarësisht nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria komisionere që plotëson kushtet për t'u kualifikuar si shoqëri komisionere e vogël dhe jo e ndërlidhur, në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje, do të dorëzojë raporte vjetore.
  
3. Informacioni i specifikuar në pikën (e) të paragrafit 1 të këtij neni duhet të përfshijë nivelet e mëposhtme të riskut dhe të raportohet të paktën në bazë vjetore:
  - (a) niveli i riskut të përqendrimit që lidhet me dështimin e një kundërpale dhe me pozicionet në librin e tregtimit mbi baza individuale apo agregate të kundërpalës;
  - (b) nivelin e riskut të përqendrimit lidhur me bankat apo shoqëritë komisionere ku mbahen paratë e klientit;
  - (c) nivelin e riskut të përqendrimit lidhur me bankat apo shoqëritë komisionere ku janë depozituar titujt e klientëve;
  - (d) nivelin e riskut të përqendrimit lidhur me bankat ku shoqëria komisionere ka depozituar cash-in e saj;
  - (e) nivelin e riskut të përqendrimit që vjen nga pesha e secilit klient në të ardhurat e portofolit;
  - (f) riskun e përqendrimit siç përshkruhet në këtë paragraf duke marrë në konsideratë aktivet dhe zërat jashtë bilancit që nuk janë regjistruar në librin e tregtimit krahas ekspozimeve që vijnë nga pozicionet në librin e tregtimit.
  
4. Informacionet në përputhje me shkronjat nga (a) në (c) të paragrafit (1) të këtij neni do t'i dorëzohen Autoritetit duke përdorur formatin në Shtojcën II.

**Neni 74**

**Masat mbikëqyrëse**

Autoriteti, në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, do të zbatojë masat përkatëse të parashikuara në ligj.

**KREU IX**  
**DISPOZITA E FUNDIT**

**Neni 75**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.



## **SHTOJCA I**

### **Administrimi i Librit të Tregtimit**

#### **Neni 1**

##### **Kërkesat për Librin e Tregtimit**

1. Pozicionet në Librin e Tregtimit do të jenë ose të tregtueshme pa kufizime, ose pozicione mbrojtëse.
2. Qëllimi tregtar evidentohet në bazë të strategjive, politikave dhe procedurave të vendosura nga institucioni për të administruar pozicionin ose portofolin.
3. Shoqëria komisionere krijon dhe mban sisteme dhe kontrole për të administruar Librin e vet të Tregtimit në përputhje me nenet 3 dhe 4 të kësaj Shtojce I.
4. Shoqëria komisionere mund të përfshijë mbrojtje të brendshme në llogaritjen e kërkesave të kapitalit për riskun e pozicionit me kusht që ato të mbahen me qëllim tregtimi dhe të plotësohen kriteret e neneve nga 2 në 5 të kësaj Shtojce I.

#### **Neni 2**

##### **Administrimi i Librit të Tregtimit**

Në administrimin e pozicioneve ose grupeve të pozicioneve të saj në Librin e Tregtimit, shoqëria komisionere duhet të përmbushë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a) shoqëria komisionere duhet të ketë në fuqi një strategji tregtare të dokumentuar qartë për pozicionin/instrumentin ose portofolet, të miratuar nga drejtuesit e lartë, e cila do të përfshijë periudhën e pritshme të mbajtjes;
- b) shoqëria komisionere duhet të ketë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për administrimin aktiv të pozicioneve të vendosura në një vend tregtimi; shoqëria komisionere duhet të ketë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për të monitoruar pozicionet kundrejt strategjisë tregtare të institucionit duke përfshirë monitorimin e qarkullimit dhe pozicioneve për të cilat është tejkalluar periudha e mbajtjes së synuar fillimisht.

#### **Neni 3**

##### **Përfshirja në Librin e Tregtimit**

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për përcaktimin e pozicionit të përfshirë në librin e tregtimit për qëllime të llogaritjes së kërkesave për kapitalin e tyre, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Shtojce I, duke marrë parasysh aftësitë dhe praktikën e administrimit të riskut të shoqërisë komisionere. Shoqëria komisionere do të dokumentojë plotësisht pajtueshmërinë e saj me këto politika dhe procedura dhe do t'ia nënshtrojë ato auditimit të brendshëm periodik.

2. Shoqëria komisionere duhet të kenë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për administrimin e përgjithshëm të Librit të Tregtimit.

## **Neni 4**

### **Kriteret për vlerësim të kujdesshëm**

1. Të gjitha pozicionet e Librit të Tregtimit do t'u nënshtrohen standardeve për vlerësimin e kujdesshëm të përcaktuar në këtë nen. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë në veçanti që vlerësimi i kujdesshëm i pozicioneve të tyre në Librin e Tregtimit të arrijë një shkallë të duhur sigurie duke pasur parasysh natyrën dinamike të pozicioneve të librit të tregtimit, kërkesat për qëndrueshmëri prudenciale dhe mënyrën e funksionimit dhe qëllimin e kërkesave të kapitalit në lidhje me pozicionet e librit të tregtimit.
2. Shoqëria komisionere duhet të krijojë dhe mbajë sisteme dhe kontrole të mjaftueshme për të ofruar raporte të matura dhe të besueshme vlerësimi. Këto sisteme dhe kontrole duhet të përfshijnë të paktën elementët e mëposhtëm:
  - a) politikat dhe procedurat e dokumentuara për procesin e vlerësimit, duke përfshirë përgjegjësitë e përcaktuara qartë të fushave të ndryshme të përfshira në përcaktimin e vlerësimit, burimet e informacionit të tregut dhe rishikimin e përshtatshmërisë së tyre, udhëzime për përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme që pasqyrojnë supozimet e institucionit se çfarë do të përdornin pjesëmarrësit e tregut në vendosjen e çmimit të pozicionit, shpeshtësinë e vlerësimit të pavarur, kohën e çmimeve të mbylljes, procedurat për rregullimin e vlerësimeve, procedurat e verifikimit në fund të muajit dhe ad-hoc;
  - b) linjat e raportimit për departamentin përgjegjës për procesin e vlerësimit që janë të qarta dhe të pavarura nga "front office".

Linja e raportimit përfundimisht do t'i përkasë organit drejtues.

3. Shoqëria komisionere duhet të rivlerësojë pozicionet e Librit të Tregtueshëm të paktën çdo ditë.
4. Shoqëria komisionere duhet të shënojë pozicionet e veta në treg kurdoherë që është e mundur, duke përfshirë aplikimin e trajtimit të kapitalit të Librit të Tregtimit.
5. Shoqëria komisionere do të krijojë dhe zhvillojë procedura për shqyrtimin e rregulimeve të vlerësimit.
6. Shoqëria komisionere do të marrë në konsideratë zyrtarisht rregullimet e mëposhtme të vlerësimit: diferencat e pafituara të kredisë, kostot e mbylljes, risqet operationale, pasigurinë e çmimeve të tregut, përfundimin e hershëm, kostot e investimit dhe financimit, kostot e ardhshme administrative dhe, sipas rastit, riskun e modelit.
7. Shoqëria komisionere do të krijojë dhe zhvillojë procedura për llogaritjen e një rregullimi të vlerësimit aktual të çdo pozicioni më pak likuid, i cili mund të lindë në veçanti nga ngjarjet e tregut ose situatat e lidhura me shoqërinë komisionere, të tilla si pozicionet e përqendruara dhe/ose pozicionet për të cilat është shtyrë periudha e mbajtjes e synuar fillimisht. Institucionet, kur është e nevojshme, do t'i bëjnë këto rregulime përveç çdo ndryshimi në vlerën e pozicionit të kërkuar për qëllime të raportimit financiar dhe do të hartojnë këto rregulime për të pasqyruar jolikuiditetin e pozicionit.

## Neni 5

### **Rezervat e mbrojtjes së brendshme (Mbrojtja e brendshme)**

1. Një mbrojtje e brendshme duhet të plotësojë veçanërisht kriteret e mëposhtme:
  - a) nuk do të ketë synim kryesor shmangien ose reduktimin e kërkesave për fonde të veta;
  - b) do të dokumentohet siç duhet dhe do t'u nënshtrohet procedurave të veçanta të miratimit të brendshëm dhe auditimit;
  - c) do të trajtohet sipas kushteve të tregut;
  - d) risku i tregut që krijohet nga mbrojtja e brendshme do të menaxhohet në mënyrë dinamike në librin e tregtueshëm brenda kufijve të autorizuar;
  - e) do të monitorohet me kujdes.

Monitorimi duhet të sigurohet me procedura të përshtatshme.

2. Kriteret e paragrafit (1) të këtij neni zbatohen pa cënuar kriteret e zbatueshme për pozicionin e mbrojtur në librin jo të tregtimit.

**SHTOJCA II**  
**Përbërja e fondeve të veta**

	(a)	(b)
	Shumat	Burimi i bazuar në numrat/shkronjat e referencës së bilancit sipas pasqyrave financiare të audituara
<b>Kapitali bazë i nivelit të parë 1 (CET1) : instrumente dhe rezerva</b>		
<b>1</b>	<b>FONDET E VETA</b>	
<b>2</b>	<b>KAPITALI I NIVELIT TË PARË</b>	
<b>3</b>	<b>KAPITAL BAZË I NIVELIT TË PARË</b>	
4	Kapitali i paguar	
5	Primet e aksioneve	
6	Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura në vitin financiar aktual	
7	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	
8	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	
9	Rezervat	
10	Rregullime të KBN1 (CET1) lidhur me filtrat prudencialë Diferenca Rivlerësimi Kreditore	
11	Rregullime të KBN1 (CET1) lidhur me filtrat prudencialë	
12	(-) ZBRITJE TOTALE NGA KAPITALI BAZË I NIVELIT TË PARË	
13	(-)Instrumentet e veta të kapitalit bazë të nivelit të parë	
14	(-) Pjesëmarrje të drejtpërdrejta të instrumenteve CET1	
15	(-) Pjesëmarrje jo të drejtpërdrejta të instrumenteve CET1	
16	(-)Pjesëmarrje sintetike të instrumenteve CET1	
17	(-)Detyrimi aktual ose i mundshëm për të blerë instrumentet e veta CET 1	
18	(-) Humbje për vitin financiar aktual	
19	(-) Emri i mirë	
20	(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	
21	(-) Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe që nuk burojnë nga diferencat e përkohshme, të netuara me detyrimet tatimore të lidhura	
22	(-) Instrumentet CET 1 dhe shoqëritë e sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm	
23	(-)Instrumentet CET 1 të shoqërive të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka një investim të rëndësishëm	
24	(-) Aktive të fondeve të pensionit me përfitim	

	të caktuar		
25	(-) Pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara në kapitalin CET 1		
26	(-) Zbritje të tjera		
27	CET1: Elementë të tjerë të kapitalit, zbritje dhe rregullime (përshtatje)		
28	<b>KAPITALI SHITESË I NIVELIT TË PARË</b>		
29	Instrumente kapitali të paguara		
30	Primet e aksioneve		
31	(-) ZBRITJE TOTALE NGA KAPITALI SHITESË I NIVELIT TË PARË		
32	(-) Instrumentet e veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë		
33	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		
34	(-) Pjesëmarrjet e tërthorta në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		
35	(-) Pjesëmarrjet sintetike në instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë		
36	(-) Pjesëmarrjet aktuale ose të mundshme për të blerë instrumente të veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë		
37	(-) Pjesëmarrjet reciproke të kryqëzuara në kapitalin shtesë të nivelit të parë		
38	(-) Instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërive të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm		
39	(-) Instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë të shoqërive të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka një investim të rëndësishëm		
40	(-) Zbritje të tjera		
41	Kapitali shtesë i nivelit të parë: Elementë të tjerë të kapitalit, zbritjet dhe rregullimet (përshtatjet)		
42	<b>KAPITALI I NIVELIT TË DYTË</b>		
43	Instrumente kapitali të paguara		
44	Borxhi i varur (Kredi të varura)		
45	Primet e emetimeve të lidhura me instrumentet		
46	(-) ZBRITJET TOTALE NGA NIVELI I DYTË		
47	(-) Instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë		
48	(-)Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë		
49	(-)Pjesëmarrjet e tërthorta në instrumente të		

	kapitalit të nivelit të dytë		
50	(-)Pjesëmarrjet sintetike në instrumente të kapitalit sintetik të nivelit të dytë		
51	(-) Detyrimi aktual ose i mundshëm për të blerë instrumente të kapitalit të nivelit të dytë		
52	(-) Pjesëmarrjet reciproke të kryqëzuara në kapitalin e nivelit të dytë		
53	(-) Instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar ku shoqëria komisionere nuk ka një investim të rëndësishëm		
54	(-)Instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të shoqërive të sektorit financiar ku shoqëria komisionere ka një investim të rëndësishëm		
55	Niveli i dytë: Elementë të tjerë të kapitalit, zbritje dhe rregullime (përshtatje).		